



Ulpiana Neighborhood | Zija Shemsiu Str. | Nr. 34 | Prishtinë | 10000 | Kosovë
T 038 700 000 | F 038 700 001 | E office@ipko.net | W www.ipko.com

OFERTA REFERENTE PËR TREGUN ME SHUMICË TË QASJES NË BREZGEJRË – BITSTREAM

Nga

IPKO TELECOMMUNICATIONS LLC

Niveli i klasifikimit: TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit: N/A
Periudha e klasifikimit: N/A
Emri i dokumentit:

Faqe 1 nga 56



PËRMBAJTJA

PJESA E PËRGJITHSHME

- 1 QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I OFERTËS REFERENTE PËR BITSTREAM
- 2 KORNIZA LIGJORE
- 3 PËRKUFIZIMI I TERMEVE/SHPREHJEVE
- 4 KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR BASHKËPUNIM
- 5 HYRJA NË FUQI DHE KOHËZGJATJA
- 6 NDËRPRERJA E MARRËVESHJES SË QASJES SË LIDHUR NË BAZË TË OR-së
- 7 SHËRBIMI BITSTREAM DHE KËRKESAT E PËRGJITHSHME
- 8 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E IPKO-s
- 9 DETYRIMET E OPERATORIT - PËRDORUESIT
- 10 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E TJERA TË PALËVE
- 11 FATURIMI DHE ARKËTIMI
- 12 SIGURIMI I DETYRIMEVE
- 13 TATIMET
- 14 PARANDALIMI I MASHTRIMIT
- 15 PERIUDHA E VLEFSHMËRISË DHE TËRHEQJA NGA MARRËVESHJA
- 16 VLEFSHMËRIA DHE NDRYSHIMI I OFERTËS REFERENTE
- 17 MBROJTJA E INFORMATAVE KONFIDENCIALE
- 18 ZGJIDHJA E KONTESTEVE
- 19 FORCA MADHORE
- 20 KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË
- 21 MENAXHIMI I OPERIMEVE TË PANDËRPRERA
- 22 ANTI-KORRUPSIONI
- 23 TË DREJTAT MATERIALE TË AUTORIT DHE TË DREJTAT E PRONËS INTELEKTUALE
- 24 MARKAT TREGTARE
- 25 SIGURIA NË PUNË
- 26 NJOFTIMET
- 27 DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

SHTOJCAT

- SHTOJCA 1 REFERENCAT
- SHTOJCA 2 PËRSHKRIMI I PRODUKTIT
- SHTOJCA 3 LISTA E ÇMIMEVE DHE PAGESAVE
- SHTOJCA 4 PROCEDURA E PAGESËS
- SHTOJCA 5 MNSH (MARRËVESHJA PËR NIVELIN E SHËRBIMIT)



1. QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I OFERTËS REFERENTE PËR BITSTREAM

1.1 Qëllimi i kësaj Oferte Referente (“OR”) është të përcaktojë kriteret dhe procedurat për rregullimin e marrëdhënieve midis IPKO Telecommunications LLC (“IPKO”) dhe Operatorit Përfitues në lidhje me ofrimin e Qasjes në Bitstream Operatorit Përfitues sipas Autorizimit nga ARKEP-i, si dhe sipas përkufizimeve të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike dhe akteve të tjera rregullatore në fuqi.

1.2 Objekt i kësaj Oferte Referente është ofrimi i shërbimeve të Qasjes në Bitstream për t’i mundësuar Operatorit Përfitues t’iu ofrojë përdoruesve fundorë shërbime të internetit duke përdorur rrjetin e qasjes në HFC në infrastrukturën e rrjetit të IPKO-s.

1.3 Operatori Përfitues mund të ketë mundësi të përshtatshme për t’u qasur në Bistream në hierarkinë e rrjetit të IPKO-s të specifikuar në këtë Ofertë Referente, që mund t’i mundësojë atij të zhvillojë plane biznesi të qëndrueshme ekonomikisht. Bazuar në vendimin nr. 1287 të ARKEP-it, të datës 26.12.2018, IPKO ka për detyrim të sigurojë qasje brezgjere (bitstream) në rrjetin ekzistues HFC përmes kabllave.

1.4. Në bazë të kësaj, IPKO do të lidhë një marrëveshje për qasje në bitstream përmes rrjetit HFC dhe do të sigurojë shërbimet për operatorin-përdoruesin siç përshkruhet në Shtojcën 2 dhe operatori-përdoruesi mund të blejë shërbime të tilla nga IPKO në nivelin me shumicë, në përputhje me çmimet e përcaktuara në Shtojcën 3, në mënyrë që ata të mund të përdorin Rrjetin e IPKO për të ofruar shërbime me pakicë për abonentët tyre në Kosovë.

1.5. Marrëveshja për qasje e lidhur në bazë të kësaj Oferte Referente nuk do të jetë ekskluzive dhe të dyja palët mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi për shërbime të llojit të njëjtë ose të ngjashëm me palë të treta gjatë afatit të vlefshmërisë së Marrëveshjes së lidhur.

1.6 Në përputhje me këtë marrëveshje për qasje të lidhur në bazë të kësaj OR-je, operatori-përdoruesi mund t’i shesë shërbimet vetëm për abonuesit e tij të regjistruar, d.m.th., vetëm për përdoruesit e tij fundorë, pa pasur mundësi t’i ofrojë ato shërbime palëve të treta për qëllime të rishitjes së mëtejme tregtare. Më tej, IPKO dhe Operatori-Përdoruesi mund të pajtohen për ofrimin e shërbimeve shtesë që nuk i nënshtrohen kësaj OR-je, të cilat do të ofrohet në bazë të një marrëveshje të veçantë për shërbime tregtare jashtë kësaj OR-je.

2. KORNIZA LIGJORE

Dispozitat e kësaj Oferte Referente janë hartuar në përputhje me: Ligjin nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike, neni 1, neni 10 paragrafi 5), nenet 30, 31, paragrafi 1) paragrafi 3.3) dhe paragrafi 4.2) dhe 4.3) dhe nenet 33, 34, 35, 36, 37 ,

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



40 dhe 79 paragrafi 1) (në tekstin e mëtejshëm: Ligji); Rregulloren nr. 27 për Analizën e Tregut, (Ref. e ARKEP me Nr. Prot. 039/B/14), neni 3, paragrafët 1), 3) dhe 4), neni 4, paragrafi 3.13) (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja për Analizën e Tregut), Rregullorja për Sigurimin e Qasjes, Nr. Prot. 012/B/11 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja për Qasje); Rregullorja për Interkoneksionin, Nr. Prot. 033/B/11; Rregullorja për Bashkë-shfrytëzimin e plotë dhe të përbashkët të lakut dhe nën-lakut lokal, Nr. Prot. 024/B/11 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja për LLU); Direktiva Nr. 2002/21/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 7 marsit 2002 për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva Kornizë), Rekomandimi i Komisionit Evropian (2003/311/EC), i ndryshuar nga Direktiva 2009/140/EC, në lidhje me Rekomandimin (2007/879/EC) i pasuar nga ai i datës 17 dhjetor 2007 për tregjet përkatëse të produkteve dhe shërbimeve brenda sektorit të komunikimeve elektronike, të ndjeshëm ndaj rregullimit *ex ante*; udhëzimet e Komisionit Evropian për analizën e tregut dhe vlerësimin e fuqisë së ndjeshme të tregut sipas kornizës rregullatore të Komunitetit për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (2002/C165/03); Vendimi nr. 950 për Analizën e Tregjeve të Qasjes me shumicë bashkë-shfrytëzim-LLU (duke përfshirë qasjen e ndarë) për laqet metalike dhe nën-laqet me qëllim ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe Qasje me shumicë brezgjere (broadband) dhe Përcaktimin e operatorit me fuqi të ndjeshme në treg, e datës 15 mars 2017, Nr. Prot. 017/B/17, Vendimet: Nr. 1033 Nr. Prot. 050/B/17, 1061 Nr. Prot. 061/B/17 dhe 1168 Nr. Prot. 013/B/18; Raporti për Analizën e Tregjeve të Qasjes me shumicë bashkë-shfrytëzim-LLU (duke përfshirë qasjen e ndarë) për laqet metalike dhe nën-laqet me qëllim ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe Qasje me shumicë brezgjere (broadband) dhe Përcaktimin e operatorit me fuqi të ndjeshme në treg (në tekstin e mëtejshëm: Raporti); në përputhje me dispozitat e nenit 13 paragrafi 1 dhe 5 të Statutit të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP).

3. PËRKUFIZIMI I TERMEVE/SHPREHJEVE

Termet dhe shprehjet e mëposhtme do të kenë këtë kuptim:

Operator - një ndërmarrje që ofron apo është e autorizuar të ofrojë një rrjet të telekomunikimeve publike apo një pajisje të lidhur.

Qasje – nënkupton vënien në funksion të infrastrukturës së telekomunikimit, (duke përfshirë ndërtesat) rrjetet dhe/ose shërbimet për një ndërmarrje tjetër sipas kushteve të përcaktuara, në baza ekskluzive dhe jo-ekskluzive, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



Konkurrenca efektive – tregu në të cilin asnjë ndërmarrje nuk klasifikohet si ndërmarrje me fuqi të ndjeshme në treg.

Tregu përkatës - tregu nga aspekti i shërbimeve/produkteve të ofruara në një zonë gjeografike të përcaktuara sipas rregullave të dhëna në Rregullore.

Shërbim i komunikimeve elektronike – shërbimi që zakonisht ofrohet me pagesë, i cili përftohet, tërësisht ose pjesërisht, nga përcjellja e sinjaleve përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike, që përfshin shërbimet e telekomunikacioneve dhe shërbimet e transmetimit në rrjetet e përdorura për transmetime radio-televizive dhe në rrjetet e televizionit kabllor, por duke përjashtuar shërbimet, të cilat ofrojnë përmbajtje nëpërmjet rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, ose që ushtrojnë kontroll redaksional ndaj përmbajtjes së ofruar për transmetimin, duke përdorur rrjetet ose shërbimet e komunikimeve elektronike. Ai nuk përfshin shërbimet e shoqërisë së informacionit, të cilat nuk përbëhen, tërësisht ose pjesërisht, nga përcjellja e sinjaleve në rrjetet e komunikimeve elektronike.

Interkoneksioni – lidhja fizike apo logjike e rrjeteve të komunikimeve publike të përdorura nga ndërmarrja e njëjtë apo e ndryshme, në mënyrë që t'u lejojë përdoruesve të një ndërmarrjeje të komunikojnë me përdoruesit e të njëjtës apo ndërmarrjes tjetër, apo të ketë qasje në shërbimet e ofruara nga ndonjë ndërmarrje tjetër. Interkoneksioni është një lloj i qasjes specifike.

Ndërmarrje - një person fizik ose juridik apo një grup i personave të lidhur nga qëllimi i përbashkët, që është e angazhuar në aktivitete të telekomunikimit në Republikën e Kosovës.

Rrjeti publik fiks – rrjeti në të cilin pikat fundore janë të vendosura në vende të fiksuara; 1.30. Rrjet publik i komunikimeve mobile – rrjeti në të cilin pikat fundore nuk janë të vendosura në vende të fiksuara;

Rrjet publik i komunikimeve mobile – rrjeti në të cilin pikat fundore nuk janë të vendosura në vende të fiksuara;

Rrjet i komunikimeve elektronike - sistemi i transmetimit dhe, nëse ekzistojnë, pajisjet e komutimit ose rutinimit dhe resurset tjera, duke përfshirë elementet e

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



rrjetit që nuk janë aktive, të cilat lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjetet satelitore, rrjetet fikse (me komutim të qarqeve ose me komutim të paketave, përfshirë internetin), rrjetet mobile tokësore, sistemet e kabllave elektrike në raste kur ato përdoren për transmetimin e sinjaleve, rrjetet e përdorura për transmetimet radiotelevizive dhe të televizionit kabllor, pavarësisht nga tipi i informacionit të bartur.

Oferta Referente – kushtet e bëra publike nga një operator, sipas të cilës ai bën një zotim për t'i ofruar qasje çdo ndërmarrje që kërkon një qasje të tillë.

Vetë-furnizimi - skicimi hipotetik i furnizimit për shërbime me shumicë nga aktiviteti biznesor i një operatori tek aktiviteti biznesor i operatorit të njëjtë, në kuptim të asaj se ajo do t'i ofrohet palëve të treta p.sh. furnizimi me informacione me shumicë nga qasja në rrjetin e aktivitetit biznesor të një operatori tek dega e shitjes me pakice e operatorit të njëjtë, për të krijuar shërbime finale të shitjes me pakicë).

Bashkëvendosje fizike (Physical Collocation) - Lloji i pajisjeve që do të përdoren nga përfituesi për qasje ose qasje në bitstream, të cilat duhet të jenë të vendosura në territorin ose në objektet që i përkasin operatorit FNT;

Përfitues – ndërmarrje për komunikime elektronike që ka lidhur një kontratë me një operator FNT për përdorimin e shërbimeve të shitjes me shumicë;

Element i shërbimit - ofrimi i shërbimeve me shumicë të përfshira në OR;

Shërbim shtesë - një pjesë e shërbimit të shitjes me shumicë të OR që përfshin bashkëvendosjen dhe rrugët primare (backhaul);

Aplikuesi – ndërmarrja për komunikime elektronike që dëshiron të marrë shërbime të shitjes me shumicë;

Pajisje - një sistem elektronik i informacionit i zhvilluar nga operatorit FNT, që është një listë ose bazë e të dhënave që i jep aplikuesit informacionin e kërkuar për të kërkuar një shërbim me shumicë;



Shërbimi me shumicë - shërbim i komunikimeve elektronike të përfshira në OR dhe të cilin operatori FNT e ofron te një ndërmarrje/operator tjetër i komunikimit elektronik, siç është qasja e hapur e lakut lokal dhe/ose qasja në bitstream.

Të gjitha termet tjerra do të kenë kuptimin siç përcaktohet në Ligj dhe në Rregullore për ofertën referente për qasje të hapur në lakun lokal dhe bitstream dhe në rregulloret tjera të ngjashme të miratuara nga ARKEP.

4. KUSHTET E PRGJITHSHME PËR BASHKËPUNIM

4.1 Licencat dhe dokumentet e kërkuara të lëshuara nga autoritetet kompetente

4.1.1. Operatori-përdoruesi që kërkon ofrimin e qasjes ose fillimin e negociatave për lidhjen e një marrëveshjeje për bitstream përmes Rrjetit HFC të IPKO në bazë të kësaj OR-je (në tekstin e mëtejshëm: “Aplikimi”) është i detyruar të sigurojë të gjitha lejet dhe miratimet nga autoritetet kompetente, në veçanti certifikatën e regjistrimit pas njoftimi të lëshuar nga Agjencia.

4.2. Kërkesa për lidhjen e marrëveshjes për qasje në bitstream përmes rrjetit HFC.

4.2.1. Operatori-përdoruesi i cili është i interesuar të lidhë një marrëveshje për qasje me shumicë bazuar në këtë OR duhet të dorëzojë në IPKO një kërkesë me shkrim.

4.2.2. Operatori-përdoruesi para negociatave për vendosjen e qasjes, përveç licencave të përmendura në pikën 4.1.1, është i detyruar të paraqesë në IPKO të dhënat e mëposhtme së bashku me kërkesën me shkrim për negociatë:

- a) Emrin dhe adresën e operatorit-përdoruesit;
- b) Lloji i shërbimeve të ofruara përmes qasjes;
- c) Adresat e pikave të qasjes nga oferta referente për të cilën operatori-përdoruesi po paraqet kërkesën për qasje;
- d) Të dhëna për pikat e qasjes nga oferta e referente për të cilën kërkohet bashkëvendosja dhe lloji i bashkëvendosjes (collocation);
- e) Trafiku i planifikuar;
- f) Afati i parashikuar (i planifikuar) i kohëzgjatjes së kontratës nuk mund të jetë më i shkurtër se 2 vjet. Kohëzgjatja e



Marrëveshjes do të specifikohet në Marrëveshje dhe do të jetë subjekt i pëlqimit.

- g) Marrëveshja e nënshkruar me Operatorin për mos-zbulimin e informacionit konfidencial (Marrëveshja e konfidencialitetit) e shkëmbyer gjatë lidhjes së marrëveshjes.

4.2.3. Kërkesa do të konsiderohet si e plotë vetëm pasi të paraqisni të gjitha të dhënat dhe dokumentet e nevojshme të përcaktuara në dispozitat e pikave 4.1.1 dhe 4.2.2.

Kërkesa duhet të paraqitet në adresën e mëposhtme: Ulpianë, “Zija Shemsiu” Nr. 34, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

4.2.4. Brenda 15 ditëve të punës nga marrja e kërkesës, IPKO do t'i dërgojë një njoftim operatorit-përdoruesit për datën e fillimit të negociatave për lidhjen e marrëveshje për qasje në bitstream përmes rrjetit HFC në bazë të kësaj OR-je. Njëkohësisht, IPKO do t'i ofrojë operatorit-përdoruesit një draft-marrëveshje për qasjen në bitstream përmes rrjetit HFC bazuar në këtë OR, e cila do të përdoret si bazë gjatë negociatave.

4.2.5. Kërkesa për OR mund të refuzohet për shkaqe të arsyeshme; në raste të tilla IPKO do të ofrojë një përgjigje ku arsyet e refuzimit do t'i jepen operatorit-përdoruesit.

4.3. Përmbyllja e negociatave:

4.3.1. Gjatë negociatave për lidhjen e marrëveshjes për qasje në bitstream përmes rrjetit HFC bazuar në këtë OR, kushtet e përcaktuara në Draft-Marrëveshjen për Qasje në bazë të kësaj OR-je mund të ndryshohen vetëm nëse ndryshimi i propozuar:

- a) nuk është në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në këtë OR;
- b) nuk shkel rregullat e zbatueshme;
- c) është dakorduar nga të dyja Palët.

4.3.2. Marrëveshja për qasje e lidhur në bazë të kësaj OR-je duhet të lidhet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës së paraqitur



nga operatori-përdoruesi me kushtin që kërkesa të mos refuzohet për arsyet e specifikuara në këtë OR.

4.4. Parimet themelore të bashkëpunimit

- 4.4.1. Për të arritur qasjen në përputhje me këtë OR, operatori-përdoruesi duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për:
- a) të mbrojtur të dhënat që Palët i shkëmbejnë me njëra-tjetrën;
 - b) të siguroar funksionimin e shërbimeve që janë subjekt i qasjes.
- 4.4.2. Bashkëpunimi do të zhvillohet në përputhje me rregulloret në fuqi, dhe çdo çështje teknike që nuk rregullohet me ligj do të menaxhohet në përputhje me specifikimet dhe standardet ndërkombëtare. Çdo çështje që nuk mbulohet nga rregulloret dhe nuk rregullohet nga specifikimet dhe standardet teknike do të dakordohet ndërmjet Palëve mbi bazën rast pas rasti.
- 4.4.3. Aplikuesi nuk do të lejojë, me dashje ose përmes neglizhencës ose një trajtimi nga pakujdesia, një veprim që mund të shkaktojë dëme në rrjetin e IPKO-s.
- 4.4.4. Qasja do të sigurohet brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes për Qasje të lidhur në bazë të kësaj OR-je, me kusht që të përmbushen të gjitha kushtet e parashikuara në këtë OR.
- 4.4.5. Zbatimi përfshin aktivitetin dhe afatet e përcaktuara në tabelën në vijim nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes për Qasje të lidhur në bazë të kësaj OR-je deri në fillimin e ofrimit të shërbimeve me shumicë. Në varësi të karakteristikave teknike dhe parashikimit të operatorit, aktivitetet shtesë harmonizohen gjatë negociatave për nënshkrimin e marrëveshjes së përgjithshme. Një pjesë e aktiviteteve do të kryhen njëkohësisht, në mënyrë që nëse operatori-përdoruesi i zbaton aktivitetet sipas planit, zbatimi i përgjithshëm nuk do të duhej të zgjasë shumë më shumë se afati i parashikuar 6-mujor.
- 4.4.6. Nëse nuk është rënë dakord ndryshe ndërmjet Palëve, pas përfundimit të suksesshëm të të gjitha kontrolleve dhe testeve të përcaktuara në pikën 4.4.5, Palët nënshkruajnë një protokoll për pranimin teknik të shërbimeve të përcaktuara në këtë OR. Nga data e



nënshkrimit, Protokolli do të konsiderohet se është realizuar në datën e ofrimit të shërbimeve me shumicë.

5. HYRJA NË FUQI DHE KOHËZGJATJA

5.1 Oferta Referencës për Qasje në Bitstream hyn në fuqi në datën e publikimit dhe do të jetë e vlefshme deri:

5.1.1 Në kohën kur Operatori Përfitues ka përfunduar afatin e autorizimit; Autorizimi është revokuar dhe Operatori Përfitues nuk ka marrë ndonjë autorizim tjetër zëvendësues për sigurimin e rrjetit dhe/ose shërbimeve të komunikimit elektronik për ofrimin e rrjetit ose shërbimeve të komunikimit elektronik;

5.1.2 Në zgjidhjen e marrëveshjes sipas dispozitave të kësaj Oferte Referente në nenin 6.

6. NDËRPRERJA E MARRËVESHJES SË QASJES SË LIDHUR NË BAZË TË OR-së

6.1. Marrëveshja mund të ndërpritet nga Palët, nëse:

6.1.1. Secila Palë mund ta ndërpresë Marrëveshjen e lidhur në bazë të kësaj OR-je në rast se Pala tjetër bën shkelje thelbësore të Marrëveshjes për arsyet e parashikuara në këtë nen (dhe nëse një shkelje e tillë nuk është eliminuar brenda 30 ditëve nga njoftimi me shkrim i dërguar nga Pala e cila nuk është fajtores, nëse largimi është i zbatueshëm në rastin specifik).

6.1.2. Secila Palë mund ta ndërpresë në njëanshëm, mbi bazën e njëanshme, Marrëveshjen e lidhur në bazë të kësaj OR-je në çdo kohë, duke i dërguar një njoftim me shkrim Palës tjetër, nëse ndodh ndonjë nga situatat e mëposhtme:

(i) Nëse Pala tjetër përballet me falimentim;

(ii) Autorizimi(et) i nevojshëm i Telekomunikimit i Palës tjetër ka skaduar ose është ndërprerë ose sekuestruar në një procedurë të kryer nga një institucion shtetëror kompetent.

(iii) Pala tjetër ndalon ofrimin e shërbimeve të komunikimit elektronik në Republikën e Kosovës; dhe/ose

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



(iv) Pala tjetër nuk ofron garancinë e fondeve siç përcaktohet në nenin 12 pasi dhënies së grejs-periodhës prej të paktën **katërmbëdhjetë (15)** ditë për sigurimin e financave përmes një njoftimi me shkrim (në kopje të shtypur ose me e-mail).

6.1.3. IPKO mund ta ndërpresë në mënyrë të njëanshme Marrëveshjen për çfarëdo arsye, me efekt të menjëhershëm në çdo kohë duke dërguar një njoftim me shkrim tek operatori-përdoruesi në rast se ndodh ndonjë nga situatat e përcaktuara më poshtë:

(i) Operatori-përdoruesi nuk i përdor shërbimet e operatorit-përdoruesit për më shumë se 3 (tre) muaj; ose ii) operatori-përdoruesi i shkelë detyrimet e tij që rrjedhin nga kjo OR dhe Marrëveshja për qasje në shërbimet bistream (për shmangie të dyshimit, kjo e drejtë e përfundimit do t'i shtohet të drejtave të tjera të renditura këtu).

6.1.4. Ndërprerja për pagesa të vonuara ose jo të plotë ose për mos ofrimin e garancisë së pagesës:

- (i) Nëse operatori-përdoruesi ka një borxh të papaguar që nuk është paguar ose nuk është paguar plotësisht brenda afateve të pagesës, IPKO do të paraqesë njoftime me shkrim në përputhje me procedurën e pezullimit të shërbimeve të përcaktuara në nenin 11 të OR-së. Nëse operatori-përdoruesi mbetet i pezulluar për një periudhë të vazhdueshme prej katërmbëdhjetë (14) ditësh për shkak të borxhit të papaguar dhe zbatimit të hapave të parashikuar në nenet 11 dhe 12;
- (ii) IPKO ka të drejtën e ndërprerjes së njëanshme të marrëveshjes pa asnjë periudhë tjetër njoftimi, duke dërguar një njoftim me shkrim për ndërprerjen e Marrëveshjes. Të njëjtat afate dhe kushte zbatohen nëse operatori-përdoruesi nuk arrin të ofrojë garancinë e pagesës në kuptim të nenit 12.

6.2. Pasojat e ndërprerjes

6.2.1. Ndërprerja e Marrëveshjes së lidhur në bazë të kësaj OR-je nuk ndikon në të drejtat dhe detyrimet e asnjërës prej Palëve që janë fituar ose janë



krijuar deri në datën e ndërprerjes dhe Palët do të vazhdojnë të jenë përgjegjëse për pagimin e shumave për shërbimet e ofruara deri në datën e ndërprerjes, pavarësisht nëse pagesa duhet të bëhet para ose pas ndërprerjes së Marrëveshjes.

- 6.2.2. Të gjitha licencat që i janë dhënë njëres palë të palës tjetër në lidhje me të drejtat e pronësisë intelektuale pushojnë të zbatohen në datën e ndërprerjes.
- 6.2.3. Ndërprerja e parakohshme nuk i kufizon detyrimet e asnjërës nga Palët për të paguar shërbimet e marra para ndërprerjes së Marrëveshjes të lidhur në bazë të kësaj OR-je.
- 6.2.4. Pas pranimit të pagesës së plotë nga operatori-përdoruesi i shumave të dakorduara të faturave të hapura, IPKO menjëherë do të kthejë çdo garanci pagese, siç parashikohet në Marrëveshjen e lidhur në bazë të kësaj OR-je.

7. SHËRBIMI BITSTREAM DHE KËRKESAT E PËRGJITHSHME

7.1 Qasja brezgjere nënkupton qasjen në rrjedhën e të dhënave digjitale ose qasjen bit-stream, e cila bën të mundur transmetimin e të dhënave brezgjere në të dyja drejtimet dhe qasjen tjetër me shumicë të dhënë në bazë të infrastrukturës, nëse dhe kur garanton shërbime të barabarta të qasjes për transmetimin digjital të rrjedhës së të dhënave.

7.2 QASJA NË BITSTREAM PËRMES RRJETIT KABLLOR

Të dhënat në sistemin kabllor përdorin disa breza frekuencash për shërbimin e transmetimit të të dhënave me shpejtësi brezgjere. Të dhënat nga përdoruesit e PC-ve transferohen përmes rrjetit HFC pasi ato modulohen nga modemi kabllor. Në krye 'headend', të dhënat në rrjedhën e sipërme transferohen në 'Cable Modem Termination System' (tani e tutje CMTS) i cili vepron si një pajisje përqendrimi dhe siguron lidhjen në rrjetin bërthamë. Në këtë pikë, të dhënat procesohen dhe shpërndahen në Internet. Kjo vlen edhe për rrjedhën e poshtme, pavarësisht se përdorin breza të ndryshme frekuencore.

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



Pika e interkoneksionit në rrjetin kabllor të IPKO-s është paraqitur në diagramin e mëposhtëm.




FIGURA 1: PIKA E DORËZIMIT TË TRAFIKUT BITSTREAM NË INFRASTRUKTURËN KABLLORE

Produktet bitstream në varësi të nivelit të qasjes në hierarkinë e rrjetit grupohen si më poshtë:

Ndërlidhja në pikën e grumbullimit: do thotë se operatori alternativ do të përdor rrjetin e qasjes të operatorëve kabllorë të angazhuar, të cilët do të instalojnë pajisjet përmes bashkëvendosjes brenda rrjetit agregat të IPKO-s që do ta trajtonin të gjithë trafikun e destinuar për konsumatorë, me origjinë nga rrjeti i operatorit-përdoruesit të caktuar. Kjo zgjidhje iu jep gjithashtu hyrësve të rinj aftësi të konsiderueshme për të diferencuar ofertat e tyre nga ato të operatorit kabllor të angazhuar.

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



7.3 IPKO do të sigurojë qasje në bistream, në përputhje me kërkesat dhe procedurat e miratuara nga ARKEP-i dhe në përputhje të plotë me nenin 5.2 dhe Shtojcën 2.

7.4 Operatori pranon dhe pajtohet që është në përgjegjësinë e tij/Operatorit të sigurojë, siç kërkohet me legjislacionin në fuqi, që çdo material i Operatorit dhe i palës së tretë të jetë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi. Për më tepër, Operatori pajtohet që IPKO nuk ka asnjë përgjegjësi në lidhje me këto materiale të Operatorit ose të palës së tretë.

7.5 Operatori do të dëmshpërblejë plotësisht IPKO-në, punonjësit e saj, ofruesit e shërbimeve të saj dhe agjentët e saj, sipas rastit, kundër çfarëdo përgjegjësie, humbjeje, kostoje, dëmtimi dhe shpenzimi (përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në, tarifat ligjore të pranueshme) të krijuara prej tij dhe që lindin drejtpërdrejt ose tërthorazi nga çfarëdo pretendimi ose veprimi i paraqitur ose që i kundërvihet IPKO-s nga një palë e tretë që pretendon se:

- 7.5.1 shërbimi është përdorur në kundërshtim me dispozitat e kësaj OR-je; ose
- 7.5.2 vjen nga instalimi nga Operatori i ndonjë pajisjeje që është bërë me Shërbimet Bitstream;
- 7.5.3 shërbimi i Operatorit është me defekte ose nuk mund të përdoret nga një palë e tretë;

7.6 Në lidhje me çështjet e përshkruara më lart, IPKO rezervon të drejtën për t'u kompensuar nga Operatori Përfitues, sipas procedurave të mëposhtme:

- a. Konfirmoni me shkrim qëllimin për të shprehur një kërkesë për kompensim brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e fakteve nga IPKO ose të jeni të vetëdijshëm për këto fakte dhe të përfshini një shënim të shkurtër për faktet përkatëse në këtë konfirmim;
- b. Ndërmerrni të gjithë hapat e nevojshëm për të zvogëluar çfarëdo humbje, pretendimi, dëmtimi, kostoje, detyrimi dhe shpenzimi, si dhe që të mos rriten ato, bëni kompromis, vendosni ose pranoni veprimet e tilla pa njoftim paraprak ndaj Operatorit Përfitues (që të mos refuzohet pa motiv);
- c. Lejoni që Operatori të jetë i vetëm në këto kërkesa, veprime, dëme, kosto dhe shpenzime, dhe
- d. Siguroni ndihmën e duhur për Operatorin që të mos krijojë ndonjë ndërhyrje të dëmshme lidhur me mbrojtjen ndaj këtyre pretendimeve, kërkesave, veprimeve, dëmtimeve, kostove dhe shpenzimeve.

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



8. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E IPKO-s

8.1 IPKO do t'i ofrojë operatorit-përdoruesit shërbime siç përshkruhen në Shtojcën 2, përkatësisht, IPKO do të:

8.1.1. Ofroj qasje në Rrjetin HFC të IPKO-s sipas kësaj OR-je.

8.1.2. Ofroj mbështetje teknike të duhur për ofrimin e Shërbimeve.

8.1.3. Do të ofrojë faturimin për shërbimet e ofruara.

8.2. IPKO merr përsipër që të mos bëjë diskriminim ndërmjet abonentëve të saj dhe abonentëve të operatorit-përdoruesit për sa i përket cilësisë, disponueshmërisë, defekteve dhe kapacitetit. Në veçanti, IPKO do t'i ofrojë të njëjtën cilësi të shërbimeve abonentëve të operatorit-përdoruesit siç u ofron abonentëve të tij, duke përfshirë trajtimin e njëjtë për sa i përket pezullimit të shërbimeve për qëllim të kryerjes së punëve të mirëmbajtjes (përfshirë riparimet, azhurnimet dhe modifikimet e rrjetit të IPKO) dhe në raste urgjente dhe në rastet e ngjarjeve të forcës madhore. IPKO ka të drejtë të menaxhojë trafikun përmes rrjetit të tij (përfshirë atë të abonentëve të operatorit-përdoruesit) për hir të mbrojtjes nga ngarkesa ose mbingarkesa e lidhjes së rrjetit ose për të lehtësuar pasojat e barrës ose mbingarkesës në pajtim me termat dhe kushtet e përgjithshme që lidhen me qasjen dhe përdorimin e shërbimeve të telekomunikimit të publikuara nga IPKO dhe llojin dhe përmbajtjen e të dhënave që do të publikohen nga Autoriteti. Situatat e dështimeve teknike të infrastrukturës së rrjetit të IPKO-s që ndikojnë njëkohësisht në përdorimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe përdoruesit e tyre nuk do të trajtohen si diskriminim.

8.3. IPKO ka të drejtë të ndryshojë portofolin e shërbimeve për abonentët e tij. Ndryshimi në portofolin e shërbimeve të ofruara nga IPKO gjithashtu mund të rezultojë në kufizime krahasuese në shërbimet e ofruara nga operatori-përdoruesi për abonentët e tij (nëse shërbimet e tilla janë pjesë e Marrëveshjes), me kusht që IPKO t'i ofrojë paraprakisht njoftim operatorit-përdoruesit siç iu ofron abonentëve të tij.

8.4. IPKO konfirmon dhe pajtohet të sigurojë marrëveshje për nivelin e shërbimit (MNSH) siç përshkruhet në Shtojcën 5.



9. DETYRIMET E OPERATORIT - PËRDORUESIT

9.1. Operatori-Përdoruesi do të jetë përgjegjës për elementët teknikë të mëposhtëm:

- a. Për platformat e veta shërbimit;
- c. Për adresat IP Publike të veta (të caktuara nga RIPE).
- d. Për pajisjet e veta (router/switch)

9.2. Operatori-Përdoruesi do të jetë plotësisht përgjegjës për faturimin e Abonentëve të tij.

9.3. Operatori-Përdoruesi është plotësisht përgjegjës për krijimin dhe ruajtjen e një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me abonentët e tij, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës (të dhënat kontraktuale të abonentëve, etj.).

9.4. Operatori-Përdoruesi do të mirëmbajë Shërbimet e veta të Kujdesit ndaj Klientit për abonentët e tij.

9.5. Operatori-Përdoruesi është përgjegjës për vendosjen e etiketës së markës, paketimin e produkteve, shpërndarjen dhe aktivitetet e marketingut.

9.6. Operatori-Përdoruesi do të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e të dhënave për abonentët e tij, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, emrin, adresën dhe vendbanimin e abonentit dhe të gjitha të dhënat e thirrjeve (CDR), siç është e zbatueshme.

9.7. Operatori-Përdoruesi është ligjërish përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve për monitorimin ligjor të komunikimeve dhe gjetjen e lokacionit të thirrjeve me kërkesë të autoriteteve shtetërore kompetente, në përputhje me ligjin në fuqi.

9.8. Operatori-Përdoruesi do të veprojë në pajtim me të gjitha ligjet dhe rregulloret (për shembull, instalimi i pajisjeve komutuese, të rrugëzimit (routing), pajisjeve për monitorimin ligjor të komunikimeve dhe ruajtjen e të dhënave të përcaktuara në Kosovë (nëse është e aplikueshme për shërbimet), dërgimin e të dhënave personale të abonentëve me qëllim të futjes në një numëror telefonik në kuadrin e shërbimit universal, të mbrojtjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave, etj.) dhe do të pranojë, mirëmbajë dhe bartë kostot e duhura për të gjitha licencat, lejet, pajisjet dhe



autorizimet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të abonentëve që janë lëndë e marrëveshjes.

9.9. Abonentët e operatorit-përdoruesit – Palët konfirmojnë që operatori-përdoruesi ka diskrecionin absolut për të përcaktuar çmimet me pakicë të shërbimeve të abonentit të ofruara në bazë të shërbimeve varësisht nga Marrëveshja, shitja, promovimi dhe shpërndarja e shërbimeve të tij tek përdoruesit fundorë, abonentët e tyre. Operatori-përdoruesi e kupton dhe pranon se do të jetë palë kontraktuese në kontratat e tij të nënshkruara me abonentët e tij.

9.10 Kujdesi ndaj klientit – Operatori-Përdoruesi është përgjegjës ekskluzivisht për thirrjet e kujdesit ndaj klientit nga abonentët e tij. Operatori-Përdoruesi tanimë do të informojë abonentët e tij për të gjitha detajet e Qendrës së Kujdesit ndaj Klientit.

9.10.1 Nëse një abonent i operatorit-përdoruesit raporton një problem tek qendra e kujdesit ndaj klientit e operatorit-përdoruesit i cili ka të bëjë me shërbimet e operatorit-përdoruesit, atëherë problemi, pas një vlerësimi dhe arsytimi, duhet të zgjidhet me mbështetjen e IPKO-s. Operatori-Përdoruesi ka të drejtë të përdorë procedurën për raportimin dhe monitorimin e defekteve siç parashikohet në Shtojcën 5.

9.10.2 Për të shmangur çfarëdo keqkuptimi, IPKO nuk është përgjegjës dhe nuk do të ofrojë kurrfarë shërbimesh të kujdesit ndaj klientit për abonentët e operatorit-përdoruesit.

9.11. Ndalimi i rishitjes së Shërbimeve të Operatorit-Përdoruesit

Operatori - Përdoruesi nuk mund të rishet shërbimet e ofruara nga IPKO tek operatorët e tjerë si palë të treta pa miratimin paraprak me shkrim nga IPKO. Për të shmangur çfarëdo keqkuptimi, Marrëveshja e lidhur në bazë të kësaj OR nuk e kufizon operatorin-përdoruesin të shesë shërbimet e tij të rishitjes nën markat e tjera të tij.

9.12 Raportimi

Sipas Rregullores për qasjen në bitstream dhe shitjen e shërbimeve të bitstream, operatori-përdoruesi do të paraqesë një raport për numrin e përdoruesve çdo muaj;

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



9.13 Pezullimi i Shërbimeve të Abonentëve individualë

- 9.13.1. Në rast se ka aktivitete të zbuluara të një abonentit të operatorit-përdoruesit që ndikojnë në integritetin e rrjetit të IPKO ose paraqesin një problem material, IPKO menjëherë do të informojë operatorin-përdoruesin për një problem të tillë material të shkaktuar nga Abonentit, dhe do të sigurojë informata të mjaftueshme në mënyrë që operatorit-përdoruesi të mund të identifikojë abonentin (ët) përkatës dhe të kërkojë pezullimin e abonentit të operatorit që është duke kryer shkeljen.
- 9.13.2 Operatori-përdoruesi do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të pezulluar shërbimet e abonentit të operatorit-përdoruesit që është duke kryer shkeljen pa vonesë për aq kohë sa abonentit(ët) është (janë) duke shkaktuar probleme.
- 9.13.3 Nëse operatori-përdoruesi nuk i pezullon abonentët e tillë pa vonesë të panevojshme, IPKO nuk do të jetë më i detyruar të ofrojë shërbimin e rënë dakord në nivelin e shërbimit të dakorduar për ata abonentë. Në një situatë të tillë, Përfituesi i operatorit-përdoruesit do të dëmshpërblejë dhe lirojë IPKO-në nga të gjitha kërkesat(paditë) dhe humbjet që rrjedhin nga një kufizim i tillë i Shërbimeve të Abonimit.
- 9.13.4 Të dyja Palët do të bashkëpunojnë ngushtë për të shmangur çfarëdo pezullimi ose çkyqje dhe për të zgjidhur çfarëdo problem material të shkaktuar nga abonentit i operatorit-përdoruesit dhe pajisjet fundore të përdorura nga abonentët e operatorit-përdoruesit sa më parë që është e mundur dhe për të zvogëluar këtë pezullim ose çkyqje në minimum.
- 9.13.5 Nëse Operatori-Përdoruesi shkel ose nuk i përmbush detyrimet e tij që rrjedhin nga ky nen 9.13 IPKO (përveç të drejtave të tjera të listuara këtu) mund të pezullojë shërbimet për të tejkaluar problemin.



10. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E TJERA TË PALËVE

10.1 IPKO do të jetë përgjegjës për furnizimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e shërbimit Bitstream të IPKO-s.

10.2 Operatori duhet të sigurojë se instalimi i shërbimeve të tij Bitstream nuk e minon tërë gamën e shërbimeve IPKO-s. Nëse abonenti i operatorit është i pakënaqur me cilësinë e shërbimeve IPKO-s gjatë ose si rezultat i instalimit të Modemit dhe Shërbimeve të Përfituesit, ky i fundit do të korrigojë problemet e shërbimit brenda një kohe të arsyeshme, të rëna dakord së pari ose të kthej instalimin në gjendjen e tij origjinale.

10.3 Operatori në përputhje me kërkesat teknike të IPKO-s për instalimin e modemit duhet të dëshmojë se defektet e instalimit janë jashtë rrejtit të tij.

10.4 Procedurat për ofrimin e Shërbimeve Bitstream, si dhe për funksionimin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme, do të specifikohen në Shtojcën për Përshkrimin e Produktit dhe në Marrëveshjen për Nivelin e Shërbimit.

11. FATURIMI DHE ARKËTIMI

11.1. Procedurat e faturimit dhe arkëtimit përcaktohen në Shtojcën 4.

11.2. IPKO do të faturojë operatorin-përdoruesin për përdorimin e shërbimit bitstream në baza mujore, ndërsa për pagesat e tjera në kohë / intervale sipas Marrëveshjes së lidhur në bazë të kësaj OR-je. IPKO do të bëjë përpjekjet maksimale për të faturuar tarifat e shërbimit jo më vonë se në ditën e tridhjetë (30) të çdo muaji (faturimi periodik).

11.3. Faturat e pakontestuara duhen paguar brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e faturës. IPKO do t'i dërgojë faturat Operatorit-Përdoruesit në mënyrë elektronike, në një adresë elektronike të përcaktuar paraprakisht. Data kur fatura dërgohet në adresën e postës elektronike të dërguar do të konsiderohet si dita e pranimit të saj. Përveç kësaj, IPKO do t'i dorëzojë faturën Operatorit-Përdoruesit gjithashtu edhe në letër, në përputhje me legjislacionin aktual. Të gjitha Pagesat (Tarifat) të përcaktuara në Marrëveshjen e arritur bazuar në këtë OR (ose shtojcat e saj) janë në



shumën neto. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) do të llogaritet dhe shfaqet në secilën faturë.

Operatorët janë të detyruar të përcaktojnë adresën e postës elektronike për marrjen e faturave.

- 11.4. Nëse një faturë e pakontestuar është paguar pas afatit, IPKO ka të drejtë të ngarkojë penalltinë e lejuar me ligj, siç përcaktohet në legjislacionin përkatës, i cili është i zbatueshëm në Republikën e Kosovës.
- 11.5. Nëse Operatori-Përdoruesi nuk paguan një shumë të pakontestuar të faturuar, brenda kohës së pranuar të pagesës, IPKO do të:
- 1) dërgoj një njoftim me shkrim për shkeljen e Operatorit-Përdoruesit ("Raporti i Kundërvajtjes") ku kërkon pagesën e shumës së pakontestuar nga Operatori-përdoruesi brenda 7 ditëve nga data e marrjes së Raportit të Kundërvajtjes.
 - 2) nëse shuma e pakontestuar që është objekt i Raportit të Kundërvajtjes mbetet e pazgjidhur edhe pas skadimit të periudhës 7-ditore, IPKO do t'i dërgojë një njoftim me shkrim Operatorit me një periudhë pagese shtesë prej 3 ditësh, pasi që nëse Operatori nuk paguan shuma e papaguar IPKO do të autorizohet të pezullojë ofrimin e shërbimeve të Operatorit-përdoruesit pa ndonjë njoftim të mëtejshëm.
- 11.6. Një pezullim i tillë do të hiqet nga IPKO në kohën më të shkurtër të mundshme. Operatori do të paguajë shumat e papaguara që janë objekt i pezullimit, nëse kushtet e ndërprerjes së Marrëveshjes nuk janë përmbushur.

12. SIGURIMI I DETYRIMEVE

12.1 Para nënshkrimit të marrëveshjes, operatori përfitues duhet të sigurojë pagesa të menjëhershme të çmimeve në përputhje me shtojcat dhe në varësi të kërkesës së Përfituesit dhe një ose më shumë forma të përshtatshme të sigurimit për shumën totale të të paktën të gjitha detyrimet e tij të vlerësuara ndaj IPKO që duhen paguar menjëherë pas aktivizimit të ndërlihdhjes në rrjet, e cila do të përcaktohet në një marrëveshje me shkrim. Shuma e saktë përcaktohet nga IPKO bazuar në Shtojcat e kësaj oferte referente dhe planet e operatorit, siç ceket në Shtojcën e letrës së synimit (kërkesë standarde). Nëse çmimet ose vëllimet e shërbimeve rriten në periudhën pasuese, IPKO ka të drejtë të kërkojë një shumë më të lartë

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



sigurimi nga operatori përfitues, e cili duhet të ofrohet brenda 15 ditëve nga dita e kërkesës. Operatori përfitues do t'i ofrojë IPKO-s një dëshmi të përshtatshme të sigurimit. Format e mëposhtme të sigurimit pranohen:

- një garanci bankare e pagueshme pas kërkesës së parë në shumën e përshkruar më poshtë, bazuar në koston dhe planin e operatorëve përfitues;
- një paradhënie në shumën e përshkruar më poshtë, bazuar në koston dhe planin e operatorëve përfitues. Sigurimi përmes pagesës paraprake kërkon një marrëveshje të veçantë midis operatorit përfitues dhe IPKO-s.

12.2 Forma e parë e sigurimit nga lista e mësipërme duhet të ketë një vlefshmëri të paktën një (1) vit. IPKO mund të kërkojë një zgjatje të periudhës së vlefshmërisë së sigurimit. Nëse pagesat e vonuara të përshkruara më poshtë ose ankesat qartazi të pabazuara ndodhin në periudhat pasuese, IPKO mund të kërkojë një sigurim të ri.

12.3 IPKO gjithashtu mund të kërkojë një sigurim të ri, në përputhje me paragrafin e parë, nëse pagesat e vonuara ose ankesat qartazi të pabaza në lidhje me detyrimet e operatorit përfitues ndodhin pasi të jetë shteruar pagesa paraprake, e cila ishte pjesë e sigurimit përmes paradhënies.

12.4 IPKO mund të arkëtojë sigurimin në rastet në vijim:

- brenda 24 orësh nëse operatori përfitues nuk paguan detyrimet e tij të papaguara për shërbimet bitstream, pavarësisht se ka marrë një shënim përkujtues për pagesë;
- nëse operatori përfitues nuk i paguan penalltitë e tija kontraktuale nga oferta referente ose marrëveshja brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës;
- nëse operatori përfitues nuk i paguan dëmet e shkaktuara IPKO-s me shkeljen e tij të detyrimeve kontraktuale ose standardeve teknike brenda 24 orëve nga data e vlerësimit të dëmit.

12.5 Shuma e një garancie bankare dhe / ose paradhënie në valutën euro, do të llogaritet, vendoset në një shumë të saktë me arsyetim dhe do të kërkohej nga IPKO në përputhje me vlerësimin e IPKO-s. Ky vlerësim do të marrë parasysh planin e zbatimit që do të ofrohet nga operatori përfitues, siç përshkruhet në këtë ofertë referente.

12.6 Garancia bankare që duhet të paraqitet nga Operatori Përfitues në favor të IPKO-s do të ketë vlefshmëri të paktën 12 muaj, duke filluar nga data e nënshkrimit të marrëveshjes me shkrim dhe do të ripërtërihet (dorëzimi i



garancisë së re bankare) një muaj para zgjatjes së periudhës së përcaktuar me marrëveshjen me shkrim. Operatori përfitues është i detyruar që brenda 15 ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes të dorëzoj brenda IPKO-s garancinë bankare të depozituar në njërin nga Bankat Tregtare në Republikën e Kosovës.

12.7 Vlera e garancisë bankare do të rishikohet me rastin e nënshkrimit të një marrëveshje të re ose në rast të ndryshimit të ndjeshëm të shërbimeve prej 30% të detyrimeve neto në tre muajt e fundit, krahasuar me detyrimet neto mbi të cilat është bërë llogaritja e fundit e garancisë bankare.

13. TATIMET

13.1. Të gjitha tarifat e parashikuara në Marrëveshjen e lidhur në bazë të OR aktuale janë dhënë në vlerë neto. TVSH-ja do të llogaritet dhe paraqitet si një artikull i veçantë në secilën faturë të lëshuar dhe do të paguhet nga Pala përgjegjëse për pagimin e faturës në përputhje me këtë Marrëveshje.

14. PARANDALIMI I MASHTRIMIT

14.1. Palët do të bashkëpunojnë vazhdimisht në përpjekje për të minimizuar përdorimin mashtrues dhe / ose të paautorizuar të rrjetit të tyre ose rrjetit të Palës tjetër.

14.2. Asnjë Palë nuk do të veprojë, me vetëdije, nga papërgjegjësia ose pakujdesia që lejon apo u mundëson të tjerëve të veprojnë ose të mos veprojnë në një mënyrë që kërcënon, shkel ose dëmton punën e rrjetit të Palës tjetër.

14.3. Asnjë Palë nuk duhet të përfshihet, ose nuk do të lejojë ose tolerojë të tjerët që të përfshihen në ndonjë përdorim mashtrues ose të paautorizuar ose në një përpjekje për të përdorur rrjetin e Palës tjetër në mënyrë të paautorizuar.

15. PERIUDHA E VLEFSHMËRISË DHE TËRHEQJA NGA MARRËVESHJA

15.1 Marrëveshja do të nënshkruhet për periudhën e rënë dakord reciprokisht, por jo për më pak se 1 vit. Pas kësaj periudhe, përveç nëse njëra nga palët dëshiron të tërhiqet nga marrëveshja duke i dërguar palës tjetër një njoftim me shkrim me këshillë të pranuar së paku tre (3) muaj para skadimit të periudhave të

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



vlefshmërisë individuale, marrëveshja do të ripërtërihet automatikisht për periudha shtesë një vjeçare.

15.2 IPKO dhe operatori përfitues mund të përfundojnë marrëveshjen gjithashtu:

- pas një njoftimi tre (3) mujor, në rast se një palë humb pozicionin e saj juridik si një operator me fuqi të ndjeshme në treg, ose nëse detyrimi i tij për të nënshkruar një marrëveshje të interkoneksionit në rrjet me operatorin përfitues pushon së ekzistuari;
- pa njoftim paraprak, nëse IPKO ose operatori përfitues janë të përfshirë në një procedurë të aftësisë paguese ose në një zgjidhje të detyrueshme;
- pa njoftim paraprak në të gjitha rastet e mashtrimit ose përpjekjes së mashtrimit, keqpërdorimit, mos pagimit ose refuzimit të pagimit të faturave brenda 15 ditëve, duke mos qenë në gjendje të paraqesin dhe ose ripërtërijnë garancinë bankare dhe / ose paradhënien dhe në rast të çfarëdo shkeljeje tjetër të rëndë të kësaj ofertë referente.

15.3 Marrëveshja ndërpritet me ligj nëse ndonjë nga operatorët përfitues humbin të drejtën e tyre për të ofruar shërbime të cilat janë me rëndësi jetike për ekzekutimin e marrëveshjes. Nëse është e nevojshme, marrëveshja me shkrim e interkoneksionit të rrjetit gjithashtu mund të ndërpritet në mënyrë që të sigurojë sigurinë e operacioneve të rrjetit, të ruajë integritetin e rrjetit, të mbrojë të dhënat, të veprojë në pajtim me rregullat e sigurisë së rrjetit, ose të sigurojë një përdorim racional të spektrit të frekuencës.

16. VLEFSHMËRIA DHE NDRYSHIMI I OFERTËS REFERENTE

16.1 Oferta referente hyn në fuqi ditën pas publikimit të saj në faqen e internetit të IPKO-s. IPKO do të ndryshojë dhe përditësojë rrjetin bazuar në operacionet e tij të biznesit dhe sipas standardeve dhe rekomandimeve të pranuar ndërkombëtarisht. Për këto dhe arsye të tjera të rëndësishme, IPKO mund të ndryshojë kushtet e kësaj oferte referente në çdo kohë.

16.2 IPKO do t'i japë operatorit përfitues një njoftim 15 ditor për çfarëdo plani për ndryshime kryesore në infrastrukturë që mund të ndikojnë në shërbimet për operatorin përfitues. Kjo ofertë referente mund të ndryshojë në bazë të vendimeve të ARKEP-it, aktgjykimeve të plotëfuqishme nga gjykata, ose kërkesave e rregulloreve në fuqi. Çfarëdo ndryshimi i ofertës referente do të publikohet në faqet e internetit të IPKO-s.

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



17. MBROJTJA E INFORMATAVE KONFIDENCIALE

17.1 Operatori përfitues është i detyruar të përdor informacionin e siguruar në lidhje me ofertën referente vetëm për qëllime për të cilat informacioni është marrë. Të gjitha informacionet në lidhje me rrjetin, shërbimet, pajisjet, ose strategjinë e biznesit të IPKO-së, ose informacione të tjera nga gama e operacioneve të IPKO-së, e cila bëhet e njohur për operatorin përfitues gjatë negociatave, pyetjeve, nënshkrimit ose ekzekutimit të marrëveshjes ose përmes ndonjë mjeti tjetër, konsiderohen sekret tregtar i IPKO-s përveç nëse palët nuk janë pajtuar ndryshe bazuar në një deklaratë me shkrim të zbatueshme për raste specifike.

17.2 Për çdo dyshim të bazuar të shkeljes së sekretit tregtar dhe konfidencialitetit të përmendur më lart të kryer nga operatori përfitues, punonjësit e tij, nënkontraktorët ose persona të tjerë të ndërlidhur, IPKO ka të drejtë të pezullojë menjëherë marrëveshjen dhe shërbimet, përderisa e informon menjëherë ARKEP-in dhe Policinë e Kosovës me qëllim të zgjidhjes së çështjes në përputhje me ligjin e zbatueshëm.

17.3 Operatori përfitues, si dhe punonjësit e tij dhe nënkontraktorët janë të detyruar të ruajnë sekretet tregtare të IPKO-së në përputhje me rregulloret e përgjegjësisë civile dhe penale; operatori përfitues duhet të siguroj që punonjësit dhe nënkontraktorët e tij janë informuar për këtë detyrim. Për çdo shkelje të dëshmuar të sekretit tregtar të mësipërm të kryer nga operatori përfitues, punonjësit e tij, nënkontraktorët ose personat e tjerë të ndërlidhur, operatori përfitues do t'i paguajë IPKO një ndëshkim/penallti kontraktuale në shumë prej 10,000 Eurove për secilën shkelje dhe të drejtën e ndërprerjes së marrëveshjes/shërbimeve, në varësi të natyrës dhe shtrirjes së zbulimit të informacionit.

17.4 Të dyja palët janë të detyruara të ruajnë sekretin dhe konfidencialitetin e komunikimeve elektronike, si dhe të dhënat personale të përdoruesve dhe abonentëve, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm. Personat e radhitur më lart duhet të ruajnë sekretin tregtar përgjatë tërë kohëzgjatjes së marrëveshjes dhe ky detyrim mbetet madje edhe pasi të përfundojnë të gjitha aktivitetet.



18. ZGJIDHJA E KONTESTEVE

18.1 Çfarëdo mosmarrëveshje eventuale në lidhje me këtë ofertë referente do të jetë objekt zgjidhjeje nga të dy palët, dhe në rast se nuk mund të gjendet zgjidhje e pranueshme për palët, autoriteti kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Arbitrazhit e Dhomës Amerikane të Tregtisë. Gjykata e Arbitrazhit do të zgjidhë konfliktet në përputhje me rregullat e saj procedurale dhe ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.

18.2 Gjykata do të përbëhet nga një organ i Arbitrazhit me tre arbitra. Secila palë do të emërojë një arbitër dhe arbitri i tretë (kryetari) do të emërohet nga dy arbitrat e parë. Gjuha e cila do të përdoret gjatë procedurës është gjuha Shqipe. Të gjitha procedurat duhet të jenë konfidenciale, përfshirë dokumentet e paraqitura nga palët në procedurë. Vendimi i Tribunalit do të jetë i plotëfuqishëm.

18.3 Pasardhësia juridike rregullohet me dispozitat e Ligjit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

19. FUQIA MADHORE

19.1 Asnjëra palë nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë vonesë në kryerjen e detyrimeve të saj sipas Oferte Referente nëse vonesa e tillë është shkaktuar nga fuqia madhore. Pala që nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e saj për shkak të fuqisë madhore, menjëherë do të njoftojë Palën tjetër për një ngjarje të tillë të fuqisë madhore, ku njoftimi i mësipërm do të përfshijë arsyet e hollësishme të fuqisë madhore.

19.2 Fuqia madhore konsiderohet një ngjarje e paparashikuar dhe e papritur e cila nuk varet nga vullneti i palëve kontraktuese dhe palët nuk kanë qenë apo nuk duhet të kenë qenë në gjendje t'i presin, parandalojnë ose shmangin ato.

19.3 Cilado palë mund të kërkojë nga pala tjetër pajtohet për një ndryshim në marrëveshje për shkak të një fuqie madhore. Kushte e Marrëveshjes do të zgjaten të paktën për kohëzgjatjen e ngjarjes së fuqisë madhore dhe palët do të bien dakord në lidhje me kushtet e reja në një formë të një aneksi të shkruar të bashkangjitur kësaj marrëveshjeje.



20. KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË

20.1 Përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë kontratë, palët nuk do të jenë përgjegjëse për ndonjë humbje apo dëm të rastësishëm, shkakor, ose ndonjë humbje apo dëm tjetër indirekt (duke përfshirë por jo të kufizuar në fitimet apo të hyrat e humbura, shpenzimet e qëndrimit në vend ose vonesës, humbje ose shkatërrim të dhënave, zbritjet dhe të gjitha pagesat për palët e treta) e as për dëmet ndëshkuese. Këto kufizime të përgjegjësive do të zbatohen pavarësisht nga forma e veprimit, qoftë në kontratë, detyrime, detyrime të rrepta, ose ndryshe, për sa kohë që pala në shkelje nuk është këshilluar me shkrim për mundësinë e dëmeve të tilla.

20.2 Palët bien dakord që çmimet dhe ndëshkimet të pasqyrojnë këtë ndarje të rreziqeve.

21. MENAXHIMI I OPERIMEVE TË PANDËRPRERA

21. Operatori garanton të zbatojë procedurat e menaxhimit të operimeve të pandërprera në rastin e situatave të jashtëzakonshme në pjesën që u takon proceseve të biznesit të tyre dhe të përgatisë një plan operimi të pandërprerë të përgatitur për rastet e tilla brenda 1 muaji nga nënshkrimi i kësaj marrëveshje.

21.2 Operatori do të azhurnojë rregullisht planin e tij të operimit të pandërprerë, dhe gjatë periudhës së vlefshmërisë së kësaj marrëveshje, do të testojë dhe aprovojë një plan të tillë së bashku me IPKO-n pas kërkesës nga IPKO një herë në vit. Në rast të rrethanave të ndryshuara të cilat mund të ndikojnë në mënyrë domethënëse në furnizimin e lëndës së kësaj marrëveshje në rast të një situatë të jashtëzakonshme, Operatori Përfitues do të informojë IPKO-n për këtë menjëherë dhe në bashkëpunim me këtë të fundit do të përshtat në mënyrë të duhur operimin e tij të pandërprerë.

21.3 Përcaktimi dhe heqja e pengesave në lidhje me sigurimin e qasjes bitstream do të bëhet në përputhje me kushtet e përcaktuara në Shtojcën 5 (Niveli i Shërbimit-MNSH)

21.4 Me qëllim të zbatimit të procedurës për raportimin dhe heqjen e një pengese, operatori-përdoruesi është i detyruar të caktojë një person kontaktues përgjegjës dhe të informojë me shkrim IPKO-n në lidhje me këtë.

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



21.5 IPKO nuk mban përgjegjësi për çfarëdo dëmi të shkaktuar për shkak të funksionimit jo të duhur të pajisjeve të sistemit në pronësi të operatorit-përdoruesit, si dhe për dëmet për të cilat është përgjegjës operatori-përdoruesi/ose ndonjë palë e tretë.

21.6 Përfituesi është i detyruar të informojë me kohë përdoruesit e tij fundorë për pengesat e mundshme në lidhje me ofrimin e Shërbimeve, nëse ata kanë informacion dhe mund të ndikojnë në ofrimin e shërbimeve të caktuara me pakicë.

21.7 Mirëmbajtja teknike e shërbimeve dhe ndryshimet eventuale në parametrat teknike dhe rregullimet e tyre kryhen ekskluzivisht nga IPKO. Mirëmbajtja teknike nuk përfshin punën dhe pjesët rezervë që IPKO do të llogarisë në mënyrë të veçantë nëse defekti ka ndodhur si rezultat i funksionimit të gabuar ose dështimit të pajisjeve fundore të përdoruesit përfundimtar të ofruara nga operatori-përdoruesi.

21.8 Operatori-Përdoruesi do të jetë përgjegjës për të gjitha dëmet e shkaktuar me qëllim të përdorimit të gabuar ose të paautorizuar ose keqpërdorimit të pajisjeve në pronësi të IPKO-s që kanë ndodhur me qëllimin e tij ose për shkak të pakujdesisë së plotë.

22. ANTI-KORRUPSIONI

22.1 PALËT deklarojnë që në asnjë fazë të lidhjes dhe/ose ekzekutimit të urdhërporosisë/marrëveshjes nuk kanë dhe nuk do të ofrojnë, japin ose premtojnë asnjë lloj përfitimit të paligjshëm për asnjë punonjës ose anëtar të menaxhmentit ose të organit mbikëqyrës ose përfaqësues, agjent të organit ose të organizatës nga sektori publik i palës tjetër, në veçanti në lidhje me:

- dhënien e transaksionit kontraktual ose
- lidhjen e marrëdhënies kontraktuale me kushte më të favorshme ose
- mos-kontrollimin e ekzekutimit të ndonjë urdhri/marrëveshjeje ose
- çdo veprim tjetër ose mosveprim që i shkakton ose mund t'i shkaktojë palës tjetër dëme ose mundëson përfitimin e paligjshëm për ndonjë punonjës ose anëtar të menaxhmentit ose organit mbikëqyrës ose përfaqësuesit, agjentit të organit ose organizatës nga sektori publik i palës tjetër.

22.2 Në rast të ndonjë shkeljeje ose tentim shkeljeje të kësaj dispozite, urdhërporosia/marrëveshja që tashmë është lidhur do të jetë e pavlefshme. Në rast se

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



urdhër-porositja/marrëveshja nuk është ende e vlefshme, do të konsiderohet sikur marrëveshja ende nuk është arritur dhe urdhër-porositja nuk është lëshuar ende.

23. TË DREJTAT MATERIALE TË AUTORIT DHE TË DREJTAT E PRONËS INTELEKTUALE

Përveç nëse parashikohet ndryshe në Marrëveshjen e Qasjes në Bitstream, të drejtat e pronësisë intelektuale do të mbeten pronë e palës që ka krijuar ose zotëruar këto të drejta, dhe asnjë dispozitë e Marrëveshjes Bitstream nuk do të konsiderohet se i është akorduar nga një Palë Palës tjetër, çfarëdo e drejtë, titull, ose licencimi i të drejtave të pronësisë intelektuale dhe asnjë dispozitë e Marrëveshjes nuk do të konsiderohet se është kufizim i të drejtave të palës tjetër për të poseduar, përdorur, gëzuar, licencuar, caktuar ose transferuar pronësinë e saj intelektuale.

24. MARKAT TREGTARE

24.1 Palët nuk do të përdorin pa pëlqimin paraprak me shkrim të palëve të tjera markat tregtare ose emrin e palës.

24.2 Përveç nëse palët bien dakord ndryshe, ato mund të përdorin markat tregtare dhe emrat e palës tjetër për qëllimet që janë të nevojshme për Marrëveshjen e Bitstream. Kur përdorë marka ose emra të tillë, pala tjetër do të ndjekë të gjitha udhëzimet e arsyeshme, por në çfarëdo rasti do të veprojë në një mënyrë që nuk do ta dëmtojë reputacionin dhe vullnetin e mirë të palës.

25. SIGURIA NË PUNË

Operatori do të kujdeset vetë për sigurinë e tij në punë. IPKO nuk ka detyrime në lidhje me lëndimin dhe nuk paguan kompensim për çfarëdo aksidenti ose lëndim të punonjësit të Operatorit Përfitues, përveç në rastet kur aksidenti ka ndodhur ekskluzivisht me faj të IPKO.

26. NJOFTIMET

26.1 Kërkesa të mëtejshme për informacione në lidhje me këtë Ofertë Referente mund të bëhen me shkrim nga palët e interesuara në pikën e mëposhtme të kontaktit të IPKO-s. Në veçanti, në rast dyshimi sa i përket interpretimit të dispozitave të kësaj oferte referente, IPKO duhet të kontaktohet. Në rast dyshimi,

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



kontakti me IPKO është paragjykim ndaj çfarëdo sqarimi të ofertës referente të dhënë nga IPKO.

26.2 Çfarëdo njoftimi ose kërkesë e shkëmbyer nga palët gjatë ekzekutimit të kësaj Oferte Referente do të bëhet me shkrim dhe do të dërgohen me postë elektronike ose me postë rekomande në adresat e përmendura në nenin 21.3. Njoftimet ose kërkesat do të kenë efekt midis palëve, pasi që pala pranuese e ka marrë njoftimin ose kërkesën. Në rast se njoftimi ose kërkesa e dërguar ka një kuptim më të madh, pala që dërgon një njoftim ose kërkesë të tillë do të kërkojë konfirmimin e marrjes nga pala pranuese dhe pala që merr një njoftim të tillë do të lëshoj konfirmimin e marrjes së njoftimit nga pala dërguese.

26.3 Të gjitha njoftimet midis Palëve do të jenë me shkrim, me faksimil (fletë pranimit), me postë rekomande ose komunikim të ngjashëm, dhe do të adresohen si më poshtë:

IPKO

Adresa: Lagjja Ulpiana, Rruga “Zija Shemsiu”, Nr. 34, Prishtinë 10000

Kosovë

Personi përgjegjës në IPKO

Tel.:

E-maili:

27. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

27.1 Pavlefshmëria ose pamundësia për të zbatuar ndonjë pjesë të Ofertës Referente për Qasje në Bitstream nuk do të ndikojë ose ndikojë në vlefshmërinë ose zbatimin e pjesës tjetër të kësaj Oferte, përveç nëse ky fakt vjen si pasojë e ndonjë vendimi të formës së prerë nga gjykata kompetente ose vendimi i arsyetuar me ligj i ARKEP-it.

27.2 Kurrfarë modifikimi, heqje ose zgjerim i dispozitave të Ofertës Referente për Qasje në Bitstream dhe Shtojcat e saj nuk do të jetë e vlefshme, përveç nëse ai është një ndryshim nga Palët që është pjesë përbërëse e Marrëveshjes së Qasjes, dhe përveç nëse parashikohet në përditësimin automatik kundrejt njoftimit

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



përkatës të palëve sipas Marrëveshjes për Qasjen Bitstream për zbatimin e kësaj RRE.

27.3 Oferta Referente për Qasje në Bitstream dhe shtojcat e saj janë përpiluar në gjuhën shqipe, në tri kopje, një kopje për secilën palë dhe një për depozitim në ARKEP.

IPKO TELECOMMUNICATIONS LLC

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



SHTOJCA 1 - TERMET DHE SHPREHJET

Në këtë Ofertë Referente, termet dhe shprehjet e mëposhtme do të kenë këtë kuptim:

Operator - një ndërmarrje që ofron apo është e autorizuar të ofrojë një rrjet të telekomunikimeve publike apo një pajisje të lidhur.

Qasje – nënkupton vënien në funksion të infrastrukturës së telekomunikimit, (duke përfshirë ndërtesat) rrjetet dhe/ose shërbimet për një ndërmarrje tjetër sipas kushteve të përcaktuara, në baza ekskluzive dhe jo-ekskluzive, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Konkurrenca efektive – tregu në të cilin asnjë ndërmarrje nuk klasifikohet si ndërmarrje me fuqi të ndjeshme në treg.

Tregu përkatës - tregu nga aspekti i shërbimeve/produkteve të ofruara në një zonë gjeografike të përcaktuara sipas rregullave të dhëna në Rregullore.

Shërbim i komunikimeve elektronike – shërbimi që zakonisht ofrohet me pagesë, i cili përftohet, tërësisht ose pjesërisht, nga përcjellja e sinjaleve përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike, që përfshin shërbimet e telekomunikacioneve dhe shërbimet e transmetimit në rrjetet e përdorura për transmetime radio-televizive dhe në rrjetet e televizionit kabllor, por duke përjashtuar shërbimet, të cilat ofrojnë përmbajtje nëpërmjet rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, ose që ushtrojnë kontroll redaksional ndaj përmbajtjes së ofruar për transmetimin, duke përdorur rrjetet ose shërbimet e komunikimeve elektronike. Ai nuk përfshin shërbimet e shoqërisë së informacionit, të cilat nuk përbëhen, tërësisht ose pjesërisht, nga përcjellja e sinjaleve në rrjetet e komunikimeve elektronike.

Interkoneksioni – lidhja fizike apo logjike e rrjeteve të komunikimeve publike të përdorura nga ndërmarrja e njëjtë apo e ndryshme, në mënyrë që t'u lejojë përdoruesve të një ndërmarrjeje të komunikojnë me përdoruesit e të njëjtës apo ndërmarrjes tjetër, apo të ketë qasje në shërbimet e ofruara nga ndonjë ndërmarrje tjetër. Interkoneksioni është një lloj i qasjes specifike.

Ndërmarrje - një person fizik ose juridik apo një grup i personave të lidhur nga qëllimi i përbashkët, që është e angazhuar në aktivitete të telekomunikimit në Republikën e Kosovës.

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



Rrjeti publik fiks – rrjeti në të cilin pikat fundore janë të vendosura në vende të fiksuara; 1.30. Rrjet publik i komunikimeve mobile – rrjeti në të cilin pikat fundore nuk janë të vendosura në vende të fiksuara;

Rrjet publik i komunikimeve mobile – rrjeti në të cilin pikat fundore nuk janë të vendosura në vende të fiksuara;

Rrjet i komunikimeve elektronike - sistemi i transmetimit dhe, nëse ekzistojnë, pajisjet e komutimit ose rutinimit dhe resurset tjera, duke përfshirë elementet e rrjetit që nuk janë aktive, të cilat lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjetet satelitore, rrjetet fikse (me komutim të qarqeve ose me komutim të paketave, përfshirë internetin), rrjetet mobile tokësore, sistemet e kabllave elektrike në raste kur ato përdoren për transmetimin e sinjaleve, rrjetet e përdorura për transmetimet radiotelevizive dhe të televizionit kabllor, pavarësisht nga tipi i informacionit të bartur.

Oferta Referente – kushtet e bëra publike nga një operator, sipas të cilës ai bën një zotim për t'i ofruar qasje çdo ndërmarrje që kërkon një qasje të tillë.

Vetë-furnizimi - skicimi hipotetik i furnizimit për shërbime me shumicë nga aktiviteti biznesor i një operatori tek aktiviteti biznesor i operatorit të njëjtë, në kuptim të asaj se ajo do t'i ofrohet palëve të treta p.sh. furnizimi me informacione me shumicë nga qasja në rrjetin e aktivitetit biznesor të një operatori tek dega e shitjes me pakice e operatorit të njëjtë, për të krijuar shërbime finale të shitjes me pakicë).

Të gjitha termet e tjerë do të nënkuptojnë siç përcaktohet në Ligj dhe rregulloret e miratuara nga ARKEP-i.



SHTOJCA 2 - PËRSHKRIMI I SHËRBIMIT

1.1 Të përgjithshme

Operatori Përfitues mund të ketë mundësi të përshtatshme për t'u qasur në Bitstream në rrjetin e IPKO-s të specifikuar në këtë Ofertë Referente, që mund t'i mundësojë atij të zhvillojë plane biznesi të qëndrueshme ekonomikisht. Bazuar në vendimin nr. 1287 të ARKEP-it, të datës 26.12.2018, IPKO ka për detyrim të sigurojë qasje brezgjere (bitstream) në rrjetin e vet kabllor HFC.

1.2 Objekti i Shërbimit

Operatorët në territorin e Kosovës mund të ofrojnë qasje brezgjere për klientët e tyre (operatorin alternativ), duke përdorur qasjen dhe teknologjinë e rrjetit bërthamë të IPKO-s. Shërbimi (përfshirë mbështetjen, rregullimin e defekteve, etj.) i ofruar për përdoruesin përfundimtar është përgjegjësi e operatorit alternativ. Shërbimi i qasjes në Bitstream do të ofrohet nga segmenti i përgjithshëm në rrjetin IPKO IP/IMPLS. Shërbimi i qasjes në Bitstream bazohet në disponueshmërinë e lartë të shërbimit, cilësinë e lartë të shërbimit të rrjetit AT, praninë mbarëkombëtare të rrjetit dhe kapacitetin brezgjere me disponueshmëri të lartë.

2. PËRSHKRIMI I HOLLËSISHËM I SHËRBIMIT

Shërbimi i qasjes në Bitstream është një shërbim që ofrohet për përdoruesit fundorë për të cilin operatori alternativ e pague IPKO-n. Operatori alternativ mundet, nëpërmjet shërbimit të qasjes në Bitstream, të përzgjedhë qasjen në rrjetin e IPKO-s dhe t'i rishesë përdoruesit fundor pakot e shërbimit të internetit të operatorit alternativ. Operatori alternativ gjithashtu mund të shesë në të ardhmen, nëpërmjet qasjes në IPKO, disa shërbime me vlerë të shtuar që do të ofrohen në të ardhmen.

Shërbimi i Bitstream do të jetë i disponueshëm vetëm në zonat ku IPKO ka kryer plotësisht migrimin në teknologjinë NGN. Në rastet kur operatori alternativ kërkon shërbime në zonat e pambuluara me NGN, kjo do të konsiderohet si rast i veçantë nga plani zhvillimor dhe kostoja e infrastrukturës do të ndahet ndërmjet IPKO-s dhe operatorit alternativ sipas kapaciteteve të blera nga operatorit alternativ.

Operatorët alternativë (ose Ofruesit e Shërbimit të Internetit - OSHI-të) janë përgjegjës për shërbimin për përdoruesin fundor.

Shërbimi Bitstream do të ofrohet për të gjithë Operatorët Alternativë/OSHI-të që kanë autorizimet përkatëse. Për operatorët që blejnë shërbimin e qasjes në internet

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



të IPKO-s, atyre mund t'iu ofrohet të negociojnë kushte më të përshtatshme për elemente të kësaj oferte referente ose këtë shërbim me kusht që nuk i nënshtrohet detyrimeve rregullatore sipas vendimit përkatës të ARKEP-it.

2.1 Opsionet e shërbimit Bitstream të ofruara nga IPKO

Shërbimi bitstream për operatorin alternativ do të ofrohet siç përshkruhet më poshtë dhe duke iu referuar skemës në vijim dhe detyrimit të IPKO-s. Më poshtë paraqiten detajet e ofrimit të shërbimit:

Ndërlidhja në pikën e grumbullimit: do thotë se operatori alternativ ose OSHI do të përdor rrjetin e qasjes të operatorëve kabllorë të angazhuar, të cilët do të instalojnë pajisjet përmes bashkëvendosjes brenda segmentit të rrjetit agregat, dhe që do ta trajton të gjithë trafikun e destinuar për konsumatorë, me origjinë nga rrjeti i OSHI-së së caktuar. Kjo zgjidhje iu jep gjithashtu hyrësve të rinj aftësi të konsiderueshme për të diferencuar ofertat e tyre nga ato të operatorit kabllor të angazhuar.

2.2 Veçoritë e Shërbimit:

1. SHËRBIMET E OPERATORIT-PËRDORUESIT JANË TË DISPONUESHME NGA DATA

Duke filluar nga data DPU, IPKO do t'i sigurojë Operatorit-Përdoruesit shërbimet siç përcaktohet në tabelën në vijim:

Lloji i shërbimit
Shërbimi Bitstream me shumicë,
- krijimi i profilit të përdoruesit
- shërbimi Bitstream me shumicë i pavarur
- linku i qasjes në Bitstream

2. Kujdesi për Klientë

2.1. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet departamenteve të kujdesit për klientë të Palëve

Nëse Departamenti i Kujdesit për Klientë i Operatorit-Përdoruesit kërkon informata përtej informatave të parapara në këtë Shtojcë, ai mund të kontaktojë drejtpërdrejt me Departamentin e Kujdesit për Klientë të IPKO-s (vetëm personeli përgjegjës). Për këtë qëllim, secila Palë do të emërojë një person kontaktues në Departamentin e Kujdesit për Klientë.

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



IPKO do të përgjigjet në këto kërkesa pa vonesë të panevojshme, në ditët e punës, nga ora 08.00-17.00.

2.2. Linja e thirrjeve urgjente e IPKO-s

Përveç personit kontaktues të paraqitur më sipër, i cili mund të kontaktohet gjatë orarit të punës, ekziston një linjë e IPKO-s për thirrje urgjente, në dispozicion 24/7, në të cilën Operatori-Përdoruesi mund të kontaktojë në raste urgjente.

2.3. Operatori-Përdoruesi duhet të jetë pika e vetme e kontaktit për abonuesit e Operatorit-Përdoruesit në lidhje me pyetjet dhe ankesat e abonuesve. Në rast se një abonues Operatorit-Përdoruesi gabimisht kontakton Qendrën e Kujdesit të Klientëve të IPKO-s, agjentët e IPKO-s do ta referojnë abonuesin në Qendrën e Kujdesit të Klientëve të Operatorit-Përdoruesit.

3. Kërkesat për ndryshime në lidhje me dizajnin dhe inxhinierinë teknike

Palët duhet të tregojnë emrat e personave kontaktues dhe të cilët janë kompetentë të veprojnë sipas kërkesave të Palëve për ndryshim në dizajnin dhe inxhinierinë teknike.

2.3 Kërkesat teknike:

Pikat e qasjes në IPKO - Lokacionet e pikave të prezencës së IPKO-s që mund të ofrojnë qasje në bitstream përmes rrjetit HFC.

IPKO ofron pikat e hyrjes në rrjet në këto lokacione:

Pikat e prezencës	CMTS
Prishtinë	CMTS-Ulpiana
Mitrovicë	CMTS-MIT
Pejë	CMTS-PE
Gjakovë	CMTS-GJK
Prizren	CMTS-PZ
Ferizaj	CMTS-FE
Gjilan	CMTS-GJIL
Fushë Kosovë	CMTS-FKS
Hajvali	CMTS-HAJ

Operatori-Përdoruesi do të shtrijë kabllot optike të tij deri në pikat e qasjes në rrjet të renditura në tabelën më sipër (d.m.th., në lokacionet më të afërta) ose në lokacionet ku kërkohet nga operatori-përdoruesi ku ekzistojnë mundësitë teknike, dhe për këtë IPKO do të faturojë Operatorin-Përdoruesin si më poshtë:

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



- Një tarifë vetëm një herë për sigurimin e lidhjes së qasjes në bitstream në pajisjet aktive të IPKO-s, posaçërisht në përputhje me Shtojcën 3;
- Tarifën mujore për mirëmbajtjen e lidhjes së qasjes në bitstream në pajisjet aktive të IPKO, posaçërisht në përputhje me Shtojcën 3.

Lokacioni i pikës së prezencës së IPKO-s për nevojat e sigurimit të qasjes në bitstream përmes rrjetit HFC. IPKO siguron pikat e qasjes në rrjet në këto lokacione:

Pikat e prezencës	CMTS
Headend	Mbulimi rajonal

2.3.3 Bashkëvendosja (Collocation)

Nëse Operatori-Përdoruesi ka nevojë për bashkëvendosjen e pajisjeve në këtë pikë të prezencës, nëse ekziston mundësia teknike, IPKO do të lidhë një marrëveshje të veçantë për bashkëvendosje brenda një afati të zbatimit prej 60 ditësh.

Çmimet për këtë shërbim janë paraqitur në Shtojcën 3 të kësaj OR-je. Për të akomoduar pajisjet e Operatorit-Përdoruesit, IPKO do të përgatisë hapësirën (Rackspace) për bashkëvendosjen e pajisjeve të Operatorit-Përdoruesit; nëse është e mundur IPKO mund të përcaktojë hapësirën për vendosjen e pajisjeve të Operatorit-Përdoruesit në një lokal tjetër brenda të njëjtit objekt.

IPKO do të sigurojë shërbimet e mëposhtme arkitekturore dhe ndërtimore-inxhinierike si pjesë e projektimit të hapësirës:

- furnizimi me rrymë;
- klimatizimi;
- mbrojtja kundër zjarreve (zbulimi i zjarrit, alarmi i zjarrit dhe fikësi i zjarrit);
- mundësia për t'u lidhur me sistemin e tokëzimit;
- kontrolli i hyrjes;
- instalimi i kablllove nga jashtë në njësinë e bashkëvendosjes së operatorit-përdoruesit;
- shërbimet e punës në ndërtesë.

IPKO do të sigurojë në secilën njësi të bashkëvendosjes një kornizë të madhësisë (në × × × d) 2200 × 600 × 600 mm me bravë sigurie për të akomoduar pajisjet e

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



transmisionit 482.6 mm (19 ") të nevojshme për zbatimin e interkoneksionit brenda 30 ditësh pas sigurimit të njësisë së bashkëvendosjes nga IPKO.

Operatori do t'i bashkëngjisë kornizës, në mënyrë të dukshme dhe të qëndrueshme, të dhënat për identifikimin e kornizës, si dhe detajet e kontaktit të nevojshme për ndërhyrje urgjente.

Për njësitë e bashkëvendosjes do të sigurohet furnizimi me energji elektrike me tension 220V dhe kufizim të rrymës prej 10 A, dhe fuqi 2kVA e furnizuar nga rrjetet publike të energjisë elektrike dhe/ose gjenerator i energjisë elektrike dizel.

Në rast të ndërprerjes së furnizimit me energji nga rrjeti publik i energjisë elektrike, gjeneratori dizel furnizon parametrat e mësipërm brenda 15 (pesëmbëdhjetë) minutave pas ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike. IPKO nuk siguron energji të pandërprerë.

IPKO do të sigurojë kushte mjedisore me gamë të temperaturës prej 19-25 ° C duke përdorur kondicioner të ajrit ose 5-40 ° C pa kondicioner të ajrit dhe lagështi relative prej 5-85%.

Pajisjet e Operatorit-Përdoruesit të vendosura në njësinë e bashkëvendosjes mund të kenë konsum total maksimal prej 1200 W për kornizë.

Korniza e vendosur në njësinë e bashkëvendosjes përfshin një shufër tokëzimi të lidhur me rrjetin ekuipotencial (EPN) të sistemit të tokëzimit të ndërtesës. Pjesët e strukturës metalike të kornizës do të lidhen me shufrën e tokëzimit në kornizë nga IPKO.

IPKO do të sigurojë:

- Eliminimin e gabimeve nga strukturat e ndërtesave dhe të elementeve të inxhinierisë ndërtimore;
- Kyçjen me hapësirën e bashkëvendosjes;
- Mirëmbajtjen e rregullt dhe rregullimin e defekteve të sistemit të alarmit të zjarrit që kanë të bëjnë me dhomën e bashkëvendosjes;
- Mirëmbajtjen e rregullt vjetore dhe rregullimin e defekteve të pajisjeve të kondicionerit të ajrit;
- Pastrimi mujor i dhomës së bashkëvendosjes dhe i ambienteve të përbashkëta;
- Përdorimi i dhomës së pushimit;

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



- Mbledhjen dhe dërgimin e mbeturinave ekskluzivisht në Shërbimet Komunale të Mbeturinave.

Pika e dorëzimit të kyçjes është ndarësi optik, i cili e përfundon fibrin optik.

Pika e hyrjes është pika e kyçjes në fund të kabllit:

- kablli i tërhequr jo metalik, ose
- Kablli i jashtëm/brendshëm jo metalik vetëm me rrjetë teli kabllin pa halogjen nga galeria në kanal in e IPKO-s, i cili mund të ndërtohet në dritaren ngjitur drejtpërdrejtë në kabllin ose kanal in hyrës. Pika e hyrjes mund të ndërtohet edhe në pikat e tjera të përcaktuara në një kontratë midis Palëve, nëse është e mundshme teknikisht.

Kostoja për aktivitetet e kabllave të kryera nga IPKO, nëse janë për Operatorin-Përdoruesin, do të përcaktohet nga IPKO sipas kostove reale. Kabllot optike, konektorët e fibrës optike, gypat e polietilenit (PE) dhe kutitë optike terminale duhet të sigurohen nga Operatori-Përdoruesi. Gypat PE dhe kutitë optike terminale duhet të jenë të llojit siç përdoren rregullisht nga IPKO. Operatori-Përdoruesi duhet t'i sigurojë IPKO-s specifikimet teknologjike të cilat duhet të zbatohen në aktivitetet e kabllave të kryera nga IPKO.

Pajisjet dhe materialet shoqëruese të Operatorit-Përdoruesit duhet të përputhen me specifikimet e sigurisë dhe standardin EN 60950.

Operatori-Përdoruesi duhet të ndërtojë një sistem sigurie për pajisjet e tij sipas specifikave të përcaktuara në IEC 172-1. Operatori-Përdoruesi duhet t'i sigurojë IPKO-s një kopje të certifikatës që konfirmon atë që u theksua më lart.

Pajisjet e Operatorit-Përdoruesit që furnizohen nga rrjeti 220V duhet të kenë tension minimal efektiv nominal prej 187V dhe tension maksimal efektiv nominal prej 242V.

Termialet e rrjetit dhe prizat e përdorura në pajisjet e Operatorit-Përdoruesit duhet të jenë në përputhje me specifikimet e standardeve EN 60320-1.



Operatori-Përdoruesi duhet të dorëzojë në IPKO një certifikatë të konformitetit EMC dhe dokumentacionin e testimit që konfirmon pajtueshmërinë me standardet ETS300 386 dhe EN 300 386.

Pajisjet e instaluar në njësinë e bashkëvendosjes së Operatorit-Përdorues që operojnë me furnizim të energjisë të siguruar nga IPKO duhet të jenë në përputhje me specifikimet e serisë së standardit ETS 300 132.

Pajisjet e Operatorit-Përdoruesit duhet të kenë një shkallë të mbrojtjes sipas IEC 529 në përputhje me vendin e aplikimit. Shenja e paralajmërimit duhet të vendoset në pjesët dhe zonat që janë subjekt i tensionit të rrezikshëm, siç specifikohet në IEC 453.

Palët duhet të përgatisin një shkresë pranim-dorëzimi për dhomën e bashkëvendosjes ku theksohet statusi i dhomës së bashkëvendosjes, detajet e konfigurimit teknik të kërkuara për bashkëvendosjen, pranimin e rregullave të aplikuara për kontrollin e hyrjes dhe rregullat e sjelljes dhe të sigurisë nga Operatori-Përdoruesi.

Përfituesi nuk mund të ndryshojë dhomën e bashkëvendosjes në aspektin e arkitekturës.

IPKO ka të drejtë të zhvendosë dhomën e bashkëvendosjes, duke e informuar Operatorin-Përdorues të paktën 1 muaj para transferimit të planifikuar. Të gjitha masat e nevojshme në lidhje me zhvendosjen do të koordinohen nga IPKO me Operatorin-Përdoruesin, duke marrë parasysh interesat e operacionit. Në këtë rast IPKO do të bartë kostot që rrjedhin nga zhvendosja.

IPKO mund të kërkojë nga Operatori-Përdoruesi që menjëherë të riparojë ose të zëvendësojë pajisjet ose pajisjen e Operatorit-Përdoruesit në njësinë e bashkëvendosjes që pengon operacionin e IPKO-s ose të pajisjeve të palëve të tjera. Nëse Operatori-Përdoruesi nuk e bën atë brenda 24 (njëzet e katër) orëve, IPKO ka të drejtë të përjashtojë pajisjet që shkaktojnë probleme pa ndonjë detyrim për të paguar kompensimin. IPKO mund të ç'kyçë menjëherë pajisjet e Operatorit-Përdoruesit që shkaktojnë probleme dhe që e rrezikojnë sigurinë e pajisjeve të IPKO-s, sigurinë e dhomës së bashkëvendosjes ose ofrimin e një shërbimi që ofrohet me pajisje të IPKO-s ose pajisje të tjera. Në këtë rast, IPKO duhet sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 24 (njëzet) orë, të informojë Operatorin-Përdoruesin për përjashtimin dhe të sigurojë arsyen e një përjashtimi të tillë.




Përshkrimi i shërbimit të qasjes në bitstream përmes HFC

1. Përshkrimi i shërbimit

1.1 Shërbimi i qasjes lokale përmes shërbimit virtual të qasjes në bitstream përmes rrjetit HFC. Operatori-Përdoruesi është i lidhur përmes optikut 1Gbit/s deri në 10Gbit/s dhe lidhjeve me pajisjet agregate të IPKO-s, **pajisjet agregate në nivelin lokal**, për ofrimin e shërbimeve për abonentët e tij.

2. Përshkrimi teknik

2.1 Përshkrimi teknik paraqitet në diagramin më poshtë:



2.2. Burimet e rrjetit të VPN të përdorura për shërbimin e qasjes lokale përmes lidhjes virtuale përfshijnë:

- Pjesë e ndarësit kryesor (ODF)
- Harta e linjës (drejtimi deri te përdoruesi fundor) së pajisjeve CMTS
- Modulatori QAM

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



- Ndarësi optik
- Nyja optike
- Amplifikatorët
- Ndarësi koaksial
- Transmisioni përmes rrjetit agregat deri në pikën e prezencës së Përfituesit

2.3. Pjesa e mësipërme nuk përfshin pjesën e shërbimit-qasjes së ofruar përmes shthurjes virtuale:

- Wi-Fi Ruter/Portë shtesë;
- Kompjuter personal.

2.4. Shërbimi i qasjes lokale përmes lidhjes virtuale zbatohet përmes qasjes në infrastrukturën e rrjetit optik-koaksial hibrid aktiv HFC (HFC-Hybrid Fiber Coaxial) të IPKO-s (me skenarin “p2mp -> point to multipoint”). Prandaj, përdoruesit e IPKO-s dhe përdoruesit e Operatorit-Përdoruesit do të ndajnë të njëjtin burim.

2.5. Përdorimi i shërbimit të qasjes lokale përmes lidhjes virtuale sigurohet për përdoruesit fundorë vetëm nga një Operator-Përdorues dhe i njëjti shërbim nuk mund të ofrohet përmes Operatorëve-Përdoruesve të tjerë.

2.6. Operatori-Përdoruesi mund të sigurojë shërbime të qasjes duke përdorur shërbimin me bazë në qasje lokale-virtuale vetëm për përdoruesit fundorë që gjenden në zonën e mbuluar nga pika lokale e prezencës së IPKO-s ku Operatori-Përdoruesi është i kyçur.

2.7. Për shërbimin virtual të qasjes në bitstream përmes HFC, kërkohet që të krijohen dhe të lëshohen VLAN-e të reja si dhe post-shërbime në kuadër të specifikimeve teknike dhe në përputhje me burimet e disponueshme. Numri i VLAN-eve që do të ndahen për çdo operator-përdorues do të jetë vetëm një, dhe ai përdoret për kyçje në internet.

3. Operatori-Përdoruesi duhet të përmbush kushtet e mëposhtme:

3.1. Operatori-Përdoruesi siguron pajisjet fundore (modemin) për klientët e tij; modemët i ofrohen Operatorit-Përdoruesit nga IPKO-ja.

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



3.2. Operatori-Përdoruesi ofron klasë të adresave IP që do t'u caktohen përdoruesve fundor në marrëveshje me IPKO-n. Ofrimi i adresave IP bëhet për secilën CMTS veç e veç. Të dhënat për përdoruesit fundorë janë në kompetencën e operatorit-përdoruesit.

3.3. Para aktivizimit të shërbimit, Operatori-Përdoruesi duhet të dërgojë dokumentacionin për vendndodhjen dhe konfigurimin e ruterit (konfigurimi i pajisjeve dhe i softuerëve)

4. Siguria standarde e shërbimit:

Në pajtim me kapacitetet teknike dhe kapacitetet për mirëmbajtjen e rrjetit IP, shërbimi i Qasjes në Bitstream përbëhet nga:

4.1. Vendosja e qasjes dhe transferimi i të dhënave

4.2. IPKO ofron qasje në rrjetin e saj IP dhe mundëson transferimin e të dhënave me shpejtësi qasjeje prej 1Gbit / s deri në 10Gbit / s nga operatori-përdoruesi (pika e qasjes në rrjet) deri në pikën e pranisë së tij.

4.3. Linku i qasjes është i një natyre “nga pika në pikë” në një nivel IP-je. Shpejtësia e linkut të qasjes do t'i nënshtrohet marrëveshjes kur shkëmbehen informacionet teknike.

4.4. Transmetimi i të dhënave - Transferimi i të dhënave ndodh përmes një lidhje IP, në të cilën paket e të DHËNAVE nga përdoruesit fundorë i transmetohen Operatorit-Përdoruesit.

4.5. Përfituesi duhet t'i qaset rrjetit IP në një pikë të veçantë të pranisë së IPKO në territorin e të cilës dëshiron të ofrojë shërbimin bistream të qasjes me shumicë për përdoruesit fundor.

4.6. Me kërkesë të Operatorit-Përdoruesit, IPKO do të dorëzojë përshkrimet e nevojshme të ndërfaqeve që përfshijnë informacionin e nevojshëm të rrugëzimit(rutinimi) dhe për komunikimin e ruterit të Operatorit-Përdoruesit me pajisjen e grumbullimit të IPKO në nivelin lokal.

4.7. Ofrimi i të gjitha shërbimeve për përdoruesit e Operatorit-Përdoruesit kryhet përmes sistemit për ofrimin e shërbimeve.

4.8. Vëllimi i të dhënave të trafikut të shërbimeve të internetit të përdoruesit fundor do të ekspozohet përmes shërbimeve të internetit, dhe do të sigurohet nga IPKO-ja për nevojat e përdoruesit të Operatorit.

5. Parametrat e qasjes në Bitstream

5.1. Shërbimi i qasjes në Bitstream siguron transferim transparent të të dhënave midis pikës fundore të rrjetit dhe pikës së qasjes në rrjetin e Operatorit-Përdoruesit.



5.2. Shërbimi i qasjes në Bitstream mund të kërkohet për pikat e përfundimit të rrjetit në territorin e Republikës së Kosovës duke përdorur burimet aktuale të rrjetit të IPKO nëse IPKO e ka atë mundësi teknike, për nevojat e Operatorit-Përdoruesit dhe përdoruesve të tij fundorë.

5.3. Operatori-Përdoruesi duhet të përdorë shërbimin e linjës së qasjes në Bitstream në përputhje me qëllimin e saj.

6. Menaxhimi

6.1. Palët nuk ofrojnë qasje në funksionet e tyre të menaxhimit të rrjetit.

7. Përshkrimi i linkut të qasjes në shërbimin bitstream

7.1. Shërbimi i qasjes në bitstream është një teknologji e IP që zbaton qasjen e të dy rrjeteve në një pikë të qasjes në rrjet.

7.2. Karakteristikat teknike të linkut së qasjes në bitstream janë:

Shpejtësia e transferit	Vendosja e lidhjes	Sistemi sipas rekomandimit të ITU-së
1GBps	LC-PC; 1000 Base-Lx (deri në 10 km)	Ndërfaqja optike
10Gbps	LC-PC; HFP (deri në 10 km)	Ndërfaqja optike

7.3. Ndarësi optik në të cilin duhet të lidhet Operatori-Përdoruesi duhet të jetë i tipit SC/APC.

7.4. Kushtet themelore për përdorimin e shërbimit

- Linku i shërbimit të qasjes në Bitstream mund të përdoret vetëm për qëllim të vendosjes së një qasjeje në bitstream.

- Pika e qasjes në rrjet është pika e dorëzimit të shërbimit ODF, e vendosur në anën e operatorit-përdoruesit, ose në anën e IPKO, varësisht se kush po e ofron lidhjen reciproke në pikat e pranisë së IPKO dhe të Operatorit – Përdoruesit, e cili është gjithashtu pikë e qasjes e shërbimit.

- Përdorimi i një linku të qasjes në shërbimin bitstream nuk mund të jetë më i shkurtër se 2 (dy) vjet. Pas skadimit të kësaj periudhe, përdorimi i një linku të shërbimit të qasjes në Bitstream mund të ripërtërihet apo zgjatet për periudhën për të cilën fillimisht ishte arritur marrëveshja.

- ndërfaqet prej 1Gbit / deri në 10Gbit / s në pikën e pranisë së operatorit-përdoruesit janë pjesë e rrjetit të operatorit-përdoruesit dhe duhet të sigurohen nga operatori-përdoruesi.

- Operatori-Përdoruesi nuk mund t'i transferojë të drejtat dhe detyrimet që kanë të bëjnë me shërbimin e në rrjedhën e poshtme në palët e treta.

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



-Operatori-Përdoruesi duhet të përdorë linkun e shërbimit të qasjes në Bitstream në përputhje me qëllimin e tij.

7.5. Linku i kontrollit të qasjes në Bitstream

Palët nuk ofrojnë qasje në funksionet e tyre të menaxhimit të rrjetit përkitazi me linkun e qasjes në bitstream.

8. Pajisjet fundore për përdoruesit fundorë (CPE/Modemi)

8.1. Pajisjet fundore të përdoruesve fundorë (CPE) ofrohen nga IPKO dhe ato mbesin pronë e IPKO-s. Kërkesat minimale të Pajisjes Fundore (CPE/Modemi) duhet të plotësojnë ekskluzivisht teknologjinë Docsis 3.0 me kanale minimale 16DS / 4US. Operatori Përdoruesi do të marrë pajisje fundore nga IPKO sipas kushteve tregtare dhe modeleve të dhura që IPKO mund të ofrojë për përdorim.

8.2. Operatori-Përdoruesi do të ketë mundësinë të zgjedhë nga një listë e paracaktuar e pajisjeve fundore të miratuara/certifikuara të IPKO-s, t% cilat kanë versionin e specifikuar të softuerit (SW) dhe firmware-it (FW).

9. Menaxhimi i pajisjeve fundore

9.1. Pajisjet terminale për përdoruesit fundorë (CPE / Modemi) do të menaxhohen nga IPKO me përdorimin e Sistemin e Menaxhimit Docsis, në të cilin nuk i lejohej qasje e drejtpërdrejtë Operatorit- Përdoruesit. Përmes shërbimit të internetit, Përfituesit do t'i mundësohet qasja e tij vetëm në përdoruesit e tij. Komunikimi i shërbimit në internet ndërmjet operatorit-përdoruesit dhe IPKO-s do të jetë asinkron.

9.2. Për menaxhimin e pajisjeve fundore të Operatorit-Përdoruesit, IPKO do të ofrojë funksionet e mëposhtme:

a) Shikimin e profilit dhe shërbimin për të gjitha llojet e shërbimeve: Internet

b) Statusin e modemit

I) statusin operacional: nëse klienti është aktiv apo i pezulluar;

II) statusin e konfigurimit: statusin e linjës së përdoruesit.

10. Kufizimet

10.1. Operatori-Përdoruesi ka të drejtë të ofrojë klasa të adresave IP të dakorduara paraprakisht në Marrëveshje me IPKO-n.

10.2. Operatori-Përdoruesi duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar abuzimin e përdorimit të shërbimeve publike të komunikimit elektronik dhe të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që përdoruesit e Operatorit-Përdoruesit të përdorin shërbimet për të cilat është lidhur kontrata.

10.3. Numri maksimal i VLAN-ëve(rrjet virtual lokal i zonës) që mund të caktohet për shërbimet e Operatorit- Përdoruesit është i kufizuar.

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



10.4. IPKO përcakton profilet e shërbimit (shpejtësinë) me të cilën do t'i ofrojë shërbimet e përdoruesit fundorë për shkak të karakteristikave teknike të ndarjes mesatare për fibrin optik dhe kabllon koaksiale.

10.5. Të gjitha kushtet dhe kufizimet, nëse janë të zbatueshme, i nënshtrohen kushteve jodiskriminuese sipas kushteve jo-diskriminuese të zbatueshme për përdoruesit e Operatorit-Përdoruesit, përfshirë nivelet e cilësisë, kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për përdorimin e shërbimeve publike të komunikimit elektronik.



SHTOJCA 3 - LISTA E ÇMIMEVE DHE PAGESAVE

1. Përfituesi mund të kërkojë nga IPKO të lejohet të paguajë një tarifë të njëherëshme për shërbimet për të cilat Palët kanë lidhur marrëveshjen për 2 (dy) ose më shumë vjet në 24 këste të barabarta mujore.

2. Kërkesa nga Përfituesi për pagimin e tarifës së njëherëshme në 24 këste të barabarta mujore do të dorëzohet në formën e një deklarate nga Operatori-Përdoruesi së bashku me një garanci të mëtejshme bankare, duke përfshirë edhe tarifën e njëherëshme që është objekt për pagesën e kësteve të barabarta mujore në kërkesën për lidhjen e Marrëveshjes së Përgjithshme për Shërbimin e Qasjes në Bitstream.

3. Tarifat e aplikueshme për shërbimin Bistream me shumicë,

3.1 Tarifat e njëherëshme

3.1.1 Tarifa e njëherëshme për krijimin e profilit të Operatorit-Përdoruesit

Tarifa e njëherëshme për krijimin e një profili të Operatorit-Përdoruesit përfshin kostot administrative për aktivitetet me shumicë, krijimin e profilit të Operatorit-Përdoruesit, aktivitetet për testimin e parametrave me Operatorin-Përdoruesin, sigurimin e llogaritjes dhe kostot për shpërndarjen e faturave të shërbimit me shumicë.

Tarifa e njëherëshme për krijimin e profilit të Operatorit-Përdoruesit	3,320 Euro
--	------------

3.1.2 Tarifa e njëherëshme për shërbimin Bistream me shumicë të pavarur

Tarifa e njëherëshme për shërbimin Bistream me shumicë të pavarur përfshin koston e lidhjes së një Linje të Abonentit Docsis

Tarifa e njëherëshme për kontratën e shërbimit Bitsream me shumicë të pavarur	37 Euro
---	---------



3.2 Tarifat Mujore

Tabela 1: Tarifat mujore për një shërbim bistream me shumicë të pavarur:

A) Pakot e paracaktuara:

Kapacitetet	Çmimi neto për Modemin Aktiv
20 Mbps	8.88€
40 Mbps	9.30€

B) Pakot e paracaktuara me kapacitetet me shumicë:

C)

Shtrirja (Mbps)	Rrjedha e Poshtme	Rrjedha e lartë	Çmimi/Mbps
1 deri në 10	1 deri në 10 Mbps	1 deri në 10 Mbps	12.00
11 deri në 20	11 deri në 20 Mbps	11 deri në 20 Mbps	8.00
21 deri në 50	21 deri në 50 Mbps	21 deri në 50 Mbps	6.00
51 deri në 100	51 deri në 100 Mbps	51 deri në 100 Mbps	5.50
101 deri në 200	101 deri në 200 Mbps	101 deri në 200 Mbps	5.00
201 deri në 300	201 deri në 300 Mbps	201 deri në 300 Mbps	3.00
301 deri në 400	301 deri në 400 Mbps	301 deri në 400 Mbps	3.00
401 deri në 500	401 deri në 500 Mbps	401 deri në 500 Mbps	3.00
Mbi 500	Mbi500 Mbps	Mbi 500 Mbps	Kontrata e përshtatur

Tabela 2

3.3. Tarifat e aplikueshme për linkut e Shërbimit të Qasjes në Bitstream:

- Tarifa e njëhershme për vendosjen e linkut të qasjes;
- Konfigurimet shtesë në linkun e qasjes



Tarifa e njehershme për Linkun e Shërbimit të Qasjes në Bitstream përfshin kostot e instalimit për instalimin e 1 (një) linku të qasjes në bitstream, përfshirë një vlerësim të aftësive teknike dhe aktiviteteve administrative me shumicë.

Distanca	L3-1GB(MCD)	L3-10GB(MCD)
Nga dhoma e sistemit IPKO deri në dollapin optik jashtë ndërtesës së	855 Euro	1055 Euro

Tarifa në lidhje me konfigurimin shtesë që kërkohet pas ofrimit dhe aktivizimit të shërbimit për operatorin-përdoruesin.

Konfigurimi i VLAN-it, VRF-së të rrjetit IP/MPLS.	854 Eur
---	---------

Nëse Operatori-Përdoruesi nuk vjen me infrastrukturën e vet optike në lokacionin e pikës së prezencës së IPKO-s, IPKO do të sigurojë infrastrukturën optike deri në lokacionin e Operatorit-Përdoruesit, dhe rrjedhimisht operator-përdoruesi do të ngarkohet me çmimin sipas kostove reale.

3.3.2 Tarifat Mujore

Tarifat mujore për shërbimin e qasjes në bitstream

Tarifat mujore për shërbimin Bitstream bazohen në kostot e shërbimeve të modelit "Bottom-Up LRIC".



SHTOJCA 4 - PROCEDURA E PAGESËS

1. Faturat dhe Pagesa

IPKO do të përgatisë një faturë mujore për Tarifat e Shërbimit që rezultojnë gjatë periudhës së faturimit.

Periudha e faturimit do të përfshijë një muaj kalendarik duke filluar nga dita e parë e muajit në ora 00:00 e që zgjat deri në ditën e fundit të muajit në ora 24: 00h. Sidoqoftë, një ngjarje që përfshin fundin e muajve fillon me atë pasuese që ndahet në fatura të dy muajve.

IPKO do t'i dërgojë faturat Operatorit-Përdoruesit në letër dhe kopjet e të dhënave në faturën në formë elektronike më së voni deri në fund të muajit pas periudhës së faturimit për të gjitha tarifatat që i referohen shërbimit për atë muaj.

Çdo faturë e dërguar nga IPKO-ja tek Operatori duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm dhe do t'i mundësojë Përfituesit të kontrollojë pajtueshmërinë e faturave të pranuar me tarifatat e dakorduara:

Fatura do të jetë në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e dispozitave të përcaktuara që janë të zbatueshme në Republikën e Maqedonisë, përfshirë, por pa u kufizuar në identifikimin e faturës unike (p.sh., numrin e faturës) dhe periudhën e faturimit.

2. Ekstrapolimi në rast të tarifave të papërcaktuara

Për të përcaktuar shumën e Faturës për Tarifën e Shërbimit, ku nuk ka shuma në dispozicion (madje edhe kur merren parasysh të gjitha fondet në dispozicion), IPKO do të kërkojë të dhëna relevante nga Operatori-Përdoruesi për të përcaktuar një përdorim të tillë.

Në rast se asnjë Palë nuk posedon të dhënat e nevojshme, do të zbatohet procedura e mëposhtme:

Nëse të paktën 50% e të dhënave të faturës nga periudha përkatëse e faturimit janë në dispozicion, do të përcaktohet një tarifë mesatare ditore për ditët e punës, të shtunat, javët dhe festat kombëtare. Shuma e faturës mujore do të ekstrapolohet në mënyrë lineare bazuar në këto tarifa mesatare ditore.

Kur më pak se 50% e të dhënave të faturës janë në dispozicion nga periudha e faturimit, të dhënat nga muaji i kaluar gjithashtu do të merren parasysh për ekstrapolim linear.

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



3. Tarifat e ndryshme

Në thelb, faturimi i tarifave të ndryshme bëhet pas dorëzimit të shërbimit.

Sidoqoftë, Palët mund të bien dakord për kushte të ndryshme pagese në lidhje me shërbimet që nuk i referohen trafikut.

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



Shtojca 5 - Marrëveshja për Nivelin e Shërbimit (MNSH)

Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit (MNSH) është një angazhim se si përcaktohet ofrimi i shërbimit ndërmjet IPKO, si ofrues i shërbimit, dhe klientit, dhe si aspekte të veçanta, që janë pjesë përbërëse e shërbimit, si cilësia, disponueshmëria, përgjegjësitë etj. të dakorduara ndërmjet ofruesit të shërbimit dhe përdoruesit të shërbimit. Qëllimi është të arrihet një marrëveshje e ndërsjellë për ofrimin dhe furnizimin e shërbimeve, duke siguruar referencë të qartë për pronësinë e shërbimit, përgjegjshmërinë, rolet dhe/ose përgjegjësitë, prezantimin e qartë, përshkrimin konciz dhe të matshëm të ofrimit të shërbimit dhe dorëzimit tek klientit dhe që ka një përputhje të pritshme të perceptimeve për ofrimin e shërbimeve dhe furnizimit me mbështetjen aktuale të shërbimit.

Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit përmban:

- Përkufizimet dhe shkurtesat;
- Kërkesat, detyrimet, detyrat dhe përgjegjësitë e palëve të përfshira;
- Llojin dhe fushëveprimin e shërbimit të ofruar;
- Nivelin e performancës së shërbimit, disponueshmërinë dhe besueshmërinë;
- Procesin e monitorimit dhe raportimin e nivelit të shërbimit;
- Hapat për raportimin e problemeve të shërbimit;
- Reagimi dhe kornizat kohore të zgjidhjes së problemeve;
- Pasojat për IPKO-n për mospërmblidhjen e angazhimit/shkeljen e MNSH-së dhe kompensimet/ rimbursimet

Përkufizimet dhe shkurtesat:

"IPKO Telecommunications" është ofrues i shërbimeve telekomunikuese që operon në bazë të ligjeve në fuqi në Kosovë dhe do të referohet si "IPKO" në tërë këtë marrëveshje.

"Klienti" është marrësi i shërbimit (ëve) (siç përmendet në Kontratë) të ofruar nga IPKO dhe do t'i referohet si "Klient" në tërë këtë marrëveshje.

"Palët" (Palët e përfshira) janë "Klienti" dhe "IPKO" dhe së bashku do të konsiderohen si "Palët" (Palët e përfshira) të kësaj marrëveshje.

"Interneti" (bashkimi i rrjetit të ndërlidhur) është sistemi global i rrjeteve kompjuterike të ndërlidhura që përdorin suitën e protokollit të Internetit (TCP / IP) për të lidhur pajisjet në mbarë botën. Ai është një rrjet i rrjeteve që përbëhet nga rrjete private, publike, akademike, biznesi dhe qeveritare të fushës lokale dhe globale, të lidhura nga një grup i gjerë i teknologjive të rrjeteve elektronike, pa tel dhe optike. Interneti ka një gamë të gjerë të burimeve të informacionit dhe shërbimeve, të tilla si dokumentet ndërlidhura të hipertekstit dhe aplikacionet në Internet në Mbarë Botën (WWW), posta elektronike, telefonia dhe ndarja e skedarëve.

Qasja në internet është aftësia e individëve dhe organizatave për t'u lidhur në internet duke përdorur terminale kompjuterash, kompjuterë dhe pajisje të tjera; dhe për t'u



qasur në shërbime të tilla si e-maili dhe në Rrjetin Mbarëbotëror të Internetit- siç definohet në Wikipedia.

“Kanalet e komunikimit” janë mjetet dhe mënyrat me të cilat palët komunikojnë ndërmjet tyre, raportojnë çështje / probleme, aranzhojnë aktivitete, raportojnë dhe njoftojnë njëra-tjetrën etj., që përfshin, por nuk kufizohen vetëm në, thirrjet telefonike - nga dhe tek personat/numrat e rënë dakord; e-mailët -nga dhe tek adresat e postës elektronike të rëna dakord; përmes ueb-portaleve të klientëve etj.

“Pikat e kontaktit” personat e përcaktuar nga palët (palët e përfshira) që do të iniciojnë, mbajnë dhe përcjellin çdo dhe të gjithë komunikimin midis palëve në lidhje me shërbimin, duke përdorur kanalet e komunikimit.

“Procesi i monitorimit” bëhet nga sistemi i monitorimit i IPKO-s, duke shkëmbyer pako ICMP me nyjet fundore / CPE, duke bërë pyetje SNMP për të marrë statusin e portit të pajisjes ose aktivitete të ngjashme për të kontrolluar disponueshmërinë e shërbimit.

“Shërbimi i monitoruar” është një mënyrë specifike me të cilën IPKO trajton ndërprerjet e shërbimit (-eve) dhe/ose mosfunksionimin. Në këtë skenar IPKO do të monitorojë, përmes ICMP dhe / ose statusit të portit ose linkut, disponueshmërinë e shërbimit për klientin dhe, në rast ndërprerjeje, sistemi automatikisht do të hapë biletën e problemeve, të cilën do ta marrin ekipet përgjegjëse , të cilët do të angazhohen në restaurimin e shërbimit

Kërkesat

Kërkesat e klientëve në mbështetje të kësaj Marrëveshjeje përfshijnë:

- pagesën për shërbimet e kontraktuara, sipas marrëveshjes së nënshkruar nga Palët / Palët e përfshira;
- sigurimin e përfaqësuesit (ëve) të klientit që do të jenë pikë (at) e kontaktit me IPKO-n, të cilët përmes kanaleve të komunikimit, do të kontaktojnë IPKO-n dhe të raportojnë dhe/ose ngrisin çfarëdo problemi në shërbimin; i/të njëjti/it person(a) i/të cili/ët do të njoftohet/n për statusin e shërbimit(ëve) dhe për çdo ndërprerje të planifikuar të shërbimit (ëve) ose kur zgjidhet një incident ose kërkesë;
- njoftimin e IPKO-s për çfarëdo problemesh eventuale dhe/ose probleme me shërbimin në tërësi ose në një segment të veçantë të shërbimit ose;
- në rastin e shërbimeve të monitoruara, njoftimin e IPKO-s për çfarëdo faktorësh dhe/ose aktiviteteve që do, të mund, kanë shkaktuar ose kanë mundur të shkaktonin ndonjë çështje/problem me shërbimin (et);
- Sigurimin e një lokacioni të përshtatshëm (në lidhje me sigurinë fizike, ftohjen e ajrit dhe lagështinë e ajrit, etj) dhe burimin e energjisë për pajisjet,



që përputhet me standardet e telekomit dhe që do të vlerësohet gjatë vendosjes së shërbimit.

- Mundësimin dhe lejimin e procesit monitorues.

Kërkesat e Ofruesit të Shërbimit në mbështetje të kësaj Marrëveshjeje përfshijnë:

- Përbushja e afateve kohore për reagim në lidhje me incidentet që kanë të bëjnë me shërbimin;
- Njoftimi i duhur i Klientit për të gjithë mirëmbajtjen e planifikuar;
- Disponueshmëria, në momentet e përcaktuara në marrëveshje, e mbështetjes teknike (dhe / ose përfaqësuesit të shitjes?), përmes kanaleve të komunikimit, për të marrë, pranuar dhe adresuar çështjet dhe / ose problemet e raportuara nga klienti.

Detyrat dhe përgjegjësitë

IPKO, me përpjekjet e tij më të mira, do t'i ofrojë Klientit shërbimin e rënë dakord të qasjes në internet dhe shërbimet mbështetëse, të përcaktuara nga parametrat si kapaciteti i brezit, disponueshmëria, besueshmëria, etj;

IPKO do të ndërhyjë, në kornizat kohore të përcaktuara në marrëveshje, në vendndodhjen e Klientëve, kur të përcaktojë se është e nevojshme që ta bëjë këtë;

Pajisjet e instaluar në vendndodhjen e Klientit janë pronë e IPKO, prandaj Klienti është i detyruar të ushtrojë kujdes maksimal për pajisjet e instaluar në vendndodhjen e tij;

Klienti është përgjegjës për vjedhjen e pajisjeve të instaluar brenda vendndodhjes së Klientit. Kur klienti e kupton që pajisjet janë vjedhur ai është i detyruar që menjëherë të informojë IPKO-n dhe Policinë, në këtë rast Klienti është i detyruar të mbulojë të gjitha shpenzimet për pajisjet e vjedhura. Në rast se Policia i gjen autorët dhe i kthen pajisjet e vjedhura në IPKO, atëherë IPKO do të rimbursojë shumën e parave të paguara nga Klienti për pajisjet e vjedhura në vendndodhjen e tij.

Nëse Klienti ndërron lokacionin IPKO duhet të informohet paraprakisht 48 orë më parë. Zhvendosja e pajisjeve do të ngarkohet në llogarinë e Klientëve sipas listës së çmimeve të IPKO-s.

Në rast të ndërprerjes së kontratës, pajisjet duhet të kthehen tek IPKO të paktën dhjetë ditë nga dita e ndërprerjes së kontratës. Klienti është i detyruar të ndihmojë IPKO-n në marrjen e pajisjeve nga vendndodhja e Klientit. - duhet të jetë pjesë e Termave dhe Kushteve? Së bashku me shumë segmente të tjera



Kjo marrëveshje nuk mund të ndryshohet pa pëlqimin me shkrim të të dyja palëve. Në rast se IPKO dëshiron të ndryshojë termat e marrëveshjes, IPKO duhet ta informojë Klientin 30 ditë më parë, duke e vendosur njoftimin në faqen e tij të internetit ose duke e dërguar njoftimin me postë tek Klienti.

Përdorimi i produkteve dhe shërbimeve të IPKO është i kufizuar shprehimisht për Klientin, emri i të cilit figuron në kontratë. Përfitimet, të drejtat dhe detyrimet e pranuar me këtë marrëveshje nga Klienti nuk mund të transferohen tek palët e treta pa një pëlqim me shkrim nga IPKO.

Konsumatori është i detyruar të përdorë shërbimet në përputhje me ligjet e zbatueshme, përndryshe IPKO rezervon të drejtën të bashkëpunojë me agjencitë kompetente të zbatimit të ligjit dhe të ndryshojë shërbimin dhe / ose të heqë pajisjet e instaluara.

IPKO nuk është përgjegjës për dëmet që rezultojnë nga përdorimi i shërbimeve ose produkteve të IPKO-së nga Klienti ose nga paaftësia e Klientit për të përdorur shërbimin e IPKO-s.

Nëse ndonjë ose më shumë paragrafë në këtë marrëveshje konsiderohen të pazbatueshme ose të pavlefshëm, kjo marrëveshje dhe të gjithë paragrafët e tjerë do të mbeten të vlefshëm.

Sistemet e komunikimit, përfshirë qasjen në internet, janë objekt i degradimit të shërbimit nga faktorë dhe shkaqe që janë përtej kontrollit dhe përgjegjësisë së arsyeshme të IPKO-s. Kjo duhet të merret në konsideratë kur vlerësohet MNSH-ja.

Termtat dhe kushtet e tjera të kësaj marrëveshje janë përcaktuar plotësisht në politikat standarde të IPKO-s. Klienti këshillohet të kërkojë shpjegime nga IPKO kur ndonjë prej kushteve të kësaj marrëveshje nuk është e qartë për ta.

Termtat e kësaj marrëveshje zëvendësojnë të gjitha deklaratat paraprake gojore, të shkruara dhe elektronike.

Lloji dhe fushëveprimi i shërbimit

IPKO do t'i sigurojë Klientit shërbimet dhe pajisjet e mëposhtme për përdorim gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshje:

- a) shërbimin e qasjes në internet njëzet e katër orë në ditë, shtatë ditë në javë, me kapacitet të brezit siç është rënë dakord në kontratë dhe me parametra si disponueshmëria, besueshmëria, kornizat kohore për reagim dhe zgjidhja e shërbimit, siç përmendet në tabelat më poshtë;
- b) Pajisjet sipas shërbimit.

Kjo mund të ndryshohet bazuar në shërbimet e rena dakord midis palëve.

Niveli i performancës së shërbimit, disponueshmëria dhe kornizat kohore

Niveli i klasifikimit:	TË DHËNA PUBLIKE/TË PAKLASIFIKUARA
Data e klasifikimit:	N/A
Periudha e klasifikimit:	N/A
Emri i dokumentit:	



IPKO, për MNSH1 (Premium/Gold), angazhohet të ofrojë një shërbim të besueshëm, me këto nivele të performancës siç paraqiten në tabelën 1.

Tabela 1: Disponueshmëria e shërbimit dhe kornizat kohore

Nr.	Artikulli	Përshkrimi	Komenti
1	Shërbimi	Përcakton llojin e shërbimit dhe parametrat e tij të tjerë si: shpejtësia, teknologjia etj.	Specifikohet sipas kontratës së shërbimit
2	Disponueshmëria	Përcakton angazhimin për disponueshmërinë e shërbimit të kontraktuar dhe matur në baza vjetore (një periudhë një vjeçare)	Ky nivel është caktuar në 99.5%
3	Koha e reagimit	Përcakton kohën për të pranuar ndërprerjen e raportuar	Ky nivel është caktuar në 15 min.
4	Koha për riparim	Përcakton kohën nga raportimi i ndërprerjes së shërbimit deri në kohën e restaurimit të shërbimit.	Ky nivel është caktuar në 4 orë
5	Ndërrimi i Harduerit	Përcakton procesin e asaj se çfarë do të zëvendësohet dhe si do të kryhet kjo	Ky proces nënkupton kur IPKO i dorëzon Harduerin klientit

Vini re se çfarëdo aktivitet i planifikuar gjatë dritareve të mirëmbajtjes të IPKO-s dhe çfarëdo ngjarje apo rast përtej kontrollit dhe përgjegjësisë së arsyeshme të IPKO që shkakton ndërprerje dhe mosfunksionim të shërbimeve do të merren parasysh në vlerësimin e MNSH-së.

Procesi i monitorimit dhe raportimi i nivelit të shërbimit

Monitorimi i shërbimit do të bëhet nga ICMP (duke përdorur mjetin ping) nga sistemi monitorues i IPKO-s deri tek pajisjet fundore në lokalet e klientit. Këto statistika do të mblidhen dhe do të jenë të disponueshme për klientin përmes portalit të internetit të klientit, dhe të mbrojtura nga kredencialet që do të vendosen nga IPKO.

Këto nivele të performancës monitorohen dhe mbikëqyren duke mbledhur lloje të ndryshme të statistikave, në afate kohore dhe shpeshtësi të aranzhuar. Këto statistika do të mblidhen dhe do të jenë në dispozicion të klientit përmes portalit të internetit të klientit. Mbledhja e statistikave përfshin, dhe nuk kufizohet vetëm në: grafikët e përdorimit të gjerësisë së bandës, mjetet e testimit të shpejtësisë, ICMP ose pyetje të tjera në drejtim të pajisjeve të klientit, portit në një ndërprerës ose të statusit të ruterit, statusit të linkut pa tel ose ndonjë mekanizëm tjetër të



monitorimit dhe mbikëqyrjes standarde të industrisë për të cilin IPKO dhe klienti kanë rënë dakord.

Raportimi i problemeve të Shërbimit

Konsumatori do t'i raportojë IPKO-s të gjitha çështjet dhe problemet me shërbimin që ata përdorin. Kjo do të bëhet nga pikat e kontaktit me përdorimin e kanaleve të komunikimit, duke vënë re sa më qartë detajet, të tilla si identifikimi i shërbimit, përshkrimi i problemit, etj. Ju lutemi referojuni tabelës 1 në lidhje me afatet kohore për reagim dhe riparim.

IPKO do të kontaktojë pikën e kontaktit dhe do t'i informojë ata për ndërprerjet e planifikuara ose të paplanifikuara të shërbimit.

Reagimi dhe korniza kohore e zgjidhjes

Afati kohor i reagimit është periudha kohore gjatë së cilës IPKO do të pranojë raportimin e ndërprerjes dhe do të fillojë hetimin e problemit.

Afati kohor për zgjidhjen e problemit është koha nga raportimi i ndërprerjes së shërbimit deri në kohën e restaurimit të shërbimit.

Pasojat për IPKO-n për mospërbushjen e angazhimit/shkeljen e MNSH-së dhe kompensimet/ rimbursimet

Nëse IPKO nuk është në gjendje të përmbushë nivelet e zotuar të performancës së shërbimit, siç paraqiten në tabelën 1, atëherë ai do të përballet me pasojat që mund të përfshijnë të drejtën e klientit për të kërkuar një rimbursim/kompensim. Nivelet e kompensimeve në faturë do të bazohen në përqindjet e shkeljes së MNSH-së.

Tabela 2: MNSH1 Tabela me kompensimet e shkeljeve

Nr.	Shkelja e MNSH-së nën nivelin e dakorduar	Niveli i kompensimit në faturë
1	deri në 5%	5%
2	deri në 10%	10%
3	deri në 15%	30%
4	deri në 20%	50%
5	deri në 50%	100%